



shqipëria Etnike



E martë 8 Maj 2018 Viti XVIII nr 162 Çmimi 30 L / 1 euro E pavarur, periodike www.shqiperia-etnike.com shqiperia_etnike@yahoo.com English, page 14 Drejtor Sokol Pepushaj



S'KANË NGA IKIN HAJDUTËT E POLITIKËS...
Spartak Ngjela
faqe 13



TAHIRI I FOLI "SHEFIT" TË TIJ ME GJUHË MAFIOZËSH...
Grida Duma
faqe 5



TEATRI ME KËSHILLIN E LARTË TË DREJTËSISË...
Ylli Manjani
faqe 5

Posta sekrete e Prokurorisë Durrës dhe "budallai" që mbush xhepin me letra



Nga: Sokol Pepushaj

Populli e ha sapunin për djathë e mban barkun bosh nga të qeshurat, por këtu ka një ndryshim të vockël. Nëse hajduti i fabulës sonë ua hidhte sigurimsave, këta hajdutët tashmi janë përballë amerikanëve e ndërkombëtarëve, ku kapjen e hajdutëve nuk e kanë sukses, por punë të zakonshme... faqe 6

Shpërthim tritoli në Shkodër, pa viktima

Mesnatën e para dy ditëve, pikërisht rreth orës 23 e 30 minuta të datës 6 maj, në shtëpinë ku flinte Indrit Puka në lagjen "Ahmet Haxhija" të qytetit të Shkodrës, ... faqe 2

Mesazhi i fortë i ambasadorit amerikan Donald Lu ndaj Ramës, Berishës e Metës, dhe përgjigja anemike nëpërmjet "lapsit" të Bushatit - faqe 3



“Shtypi duhet të jetë i lirë për të shprehur aktualitetin ashtu siç është realisht”, pse është zgjedhur 3 maji si dita ndërkombëtare e lirisë së mediave.

E themeluar nga UNESCO në vitin 1993, Dita Ndërkombëtare e Shtypit përfaqëson një mënyrë për të festuar dhe kërkuar lirinë e shtypit në mbarë botën.

Ashtu si çdo njeri që gëzon lirinë e fjalës, ashtu edhe shtypi duhet të jetë i lirë për të shprehur aktualitetin ashtu siç është realisht.

Themeluesit e ditës ndërkombëtare të shtypit si qëllim kryesor kanë pasur mbrojtjen e gazetarëve nga sulmet e ndryshme, po ashtu edhe për të pasur një ditë të shënuar ku t’ju bëhen homazhe gazetarëve të rënë në krye të detyrës.

Sot janë të shumtë ata që i bëjnë thirrje qeverisë t’a fuqizojë lirinë e shtypit, t’ju sigurojë mbrojtje të gjithë gazetarëve dhe bota e mediave të mos jetë nën tutelë, por të shprehë lirshëm aktualitetin dhe lirinë e mendimit.

3 Maj-i nuk është zgjedhur rastësisht si dita ndërkombëtare e shtypit, por është përvjetori i Deklaratës të Windhoek, një deklaratë në mbrojtje të lirisë së shtypit afrikan në 1991.



Informaliteti me pagat, Rama: Aksion kundër dy borderove në biznese



Një tjetër çështje që kryeministri e renditi si prioritet të qeverisë, ishte informaliteti në deklarimin e pagave.

Ai akuzoi se bizneset deklarojnë paga shumë më të ulta, sesa realisht paguajnë punonjësit, ndërsa premtoi një aksion për t’i dhënë fund njëherë e mirë këtij fenomeni.

“Ka një problem real, që lidhet me shmangien e taksave, pasi bizneset

deklarojnë paga shumë më të ulta, sesa paguajnë realisht punonjësit.

Askush nuk e beson se një inxhinier apo një menaxher i lartë, të paguhet 35 mijë lekë në muaj, ndaj ne tani do të nisim një aksion, për të verifikuar të gjitha bilancet e kompanive dhe për t’i dhënë fund punës me dy bordero të bizneseve”, deklaroi Rama.

Shpërthim tritolli në Shkodër, pa viktima

Mesnatën e para dy ditëve, pikërisht rreth orës 23 e 30 minuta të datës 6 maj, në shtëpinë ku flinte Indrit Puka në lagjen “Ahmet Haxhija” të qytetit të Shkodrës, ka shpërthyer një sasi tritolli prej 200 gramësh. Lënda plasëse është hedhur në oborrin e shtëpisë nga persona ende të paidentifikuar, ku nuk ka patur të lënduar. Sipas informacioneve të para, ky shpërthim ka patur për autor pjesëtar të familjes Pirani, një fis i njohur për policinë, por që vazhdimisht kanë arritur edhe të kryejnë krime e ti shpëtojnë drejtësisë, falë lidhjeve me politikanë që përmes kimit grumbullojnë vota në kohë fushatash.

Indrit Puka ka pakë ditë që është kthyer nga shteti francez, ku kishte kërkuar azil për konflikte prone me familjen Pirani.

Këto dy fise, që në vitin 2009 kishin konflikte të forta për pronën. Familja Puka kishte qëndruar shumë kohë e ngujuar nga frika e vrasjes. Në kushtet e rrezikut për jetën, ishin larguar familjarisht drejt Francës, por kohët e fundit njëri nga djemtë e kësaj familjeje, Indrit Puka, u kthye mbrapsht nga shteti francez dhe sapo erdhi, i qëndruan gati me tritol.

Në fakt, edhe dy vjet më parë familja mafioze Pirani ka vrarë me armë zjarri pikërisht në këtë lagje ku jeton Indrit Puka, pra në lagjen “Ahmet Haxhija” shtetasin Mir Alija. Ngjarja e fundit ka tronditur banorët e lagjes, pasi shpërthimi ka qënë i fuqishëm.



Mesazhi i fortë i ambasadorit amerikan Donald Lu ndaj Ramës, Berishës e Metës, dhe përgjigja anemike nëpërmjet “lapsit” të Bushatit

Skeçi i Portokallisë së kësaj jave nuk duket se ishte thjesht një fabul komike, pasi duket se përbente një metaforë reale të asaj që Donald Lu-ja personazhi real i skeçit donte të përcillte.

Fraza e Lu-së ishte lapidare kur personazhit të Edi Ramës në show-un komik ai i bëri thirrje: “Ndaje mendjen do shkosh këndeje apo andej”.

Kush ka mend në kokë e kuptoi qartë, prerë dhe saktë mesazhin e qeverisë së Donald Trumpit, e cila sapo i ka zgjatur mandatin ambasadorit të saj në Tiranë.

Në mënyrë precise në Portokalli

me Berishën apo me SHBA-në.

Mesazh më i qartë nuk ka pasur ndonjëherë.

Dhe menjëherë pas asaj performace që ishte shumë e qartë dhe që pati një përkrahje shumë të madhe nga publiku në sale (në portokalli nuk shkojnë njerëz me 5 mijë lekë, por ai që do dhe që e paguan biletën), një zë nga qarqet anti reform e ka cilësuar vettingun si një kob.

Është Anti Bushati, gazetari që për 4 vjet nuk është vetëm kundërshtari i Edi Ramës, por lustraxhiu i Bashës dhe Kryemadhit sot dhe Berisha-Metës dje.

“Fatëkeqësisht, ashtu siç ka ndodhur edhe më parë, në Shqipëri, po triumfon gjuetia e shtrigave ndaj të djeshmes, përpara preokupimit për të nesërmen.

Dhe ky është sinjali që duhet të n'a shqetësojë.

Sepse as deklamimet e diplomatëve dhe qeveritarëve as enumeracioni që ata i bëjnë kokave të prera deri më tani, nuk janë një garanci për të ardhmen. Në të kundërtën, ato mund të jenë spektakli zhurmëmadh që na pengon t'i shohim rreziqet e saj”.

Pra në mënyrë të qartë, njeriu fenomen që nuk thërriti asnjë here për

të pasurisë së zyrtarëve më të lartë të shtetit.

Në botën perëndimore, por edhe lindore, është standard, madje ka qenë edhe në perandoritë e vjetra që nga ajo Romake, Bizanti e madje edhe osmanët që kadiun që madje nuk i jepnin as grua që të mos ketë kunetër e krushq për të favorizuar e fshehur pasurinë.

Tashmë po duket e qartë se ajo që ka ndodhur në këto katër vite ka qenë një luftë e hapur pro dhe kundër pastrimit të zyrtarëve të shtetit shqiptar.

Andi Bushati e tha qartë dhe nuk ka dyshim se lufta e tij kundër krimit e korrupsionit është pikërisht për ta



personazhet e Berishës, Bashës dhe Monika Kryemadhit ishin në një front, Edi Rama ishte në mes dhe lëvizte here këndeje e here andej, ndërsa Donald Lu-ja, jo personazhi, por ambasadori i SHBA-së në Tiranë i bënte thirrje aktorit që imitonte kryeministrit që ta ndante mendjen nëse do ishte

Anti Bushati, sëbashku me Shkullakun është kalemi zyrtar i antireformës në drejtësi.

Sot Bushati shkruan i shqetësuar në përkrahjen popullore për largimin e të korruptuarve nga drejtësia.

Bushati, i cili sulmon ashpër Donald Lu-në shkruan se

krimin dhe mafia-n në Shqipëri, madje është paguar kokërr më kokërr, e quan gjueti shtrigash një process kontrolli pasurie.

Gjueti shtrigash është të akuzosh pa baza, gjueti shtrigash është të sulmosh të pambrojturin, ose viktimën që do t'i marrësh gjobën, por jo kontrollit

mbrojtur atë.

E jo më kot sulmojnë edhe Donald Lu-në, duke shpresuar se Trump do ta heqë.

Porduket se Trump-i dëgjoi shqiptarët dhe jo Bushatët...

Ilir Meta s' duhej ta mblidhte KLD, zyrtarisht është shuar. Riktheu Shpresa Beçajn e gjyqtarë që duhej të ishin në burg, tani shet votuesit e bën si shpirt i keq

Ilir Meta thotë se ndjen keqardhje pse nuk ishin shkarkuar disa gjyqtarë nga ana e KLD, duke lënë për të kuptuar se ai si kryetar ka vetëm një votë. Madje bën dhe hipokritin në përgjigjen e tij përmes zëdhënësit, për Ministren e Drejtësisë Etilda Gjonaj se, prandaj duhet të bëhet shpejt reforma në drejtësi.

Ndërkohë që kërkon me urgjencë ngritjen e insmtitucioneve të reja të drejtësisë, teksa thotë se mbledhja e ditës së djeshme dhe vendimarrja e shumicës së anëtarëve të KLD-së për procedimin e gjyqtarëve tregon edhe njëherë nevojën ekstreme që ka vendi, për ngritjen dhe funksionimin sa më parë të organeve të reja të sistemit të drejtësisë që janë parashikuar nga re-

forma.

Një hipokrizi e gjallë e Metës si kryetar i KLD teksa thotë se “KLD sot funksionon bazuar në dispozita tranzitore dhe kjo gjëndje duhet të marrë fund sa më parë. Ngritja dhe funksionimi i organeve të reja si; Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do të vendosë çdo gjyqtar përballë një sistemi objektiv të llogaridhënies për veprimtarinë e tij.

Shkeljet disiplinore të kryera nga disa gjyqtarë të shqyrtuara ditën e djeshme në KLD ishin më tepër se flagrante dhe me pasoja të rënda.

Votimi i djeshëm për këto raste tregoi se KLD nuk i përgjigjet dot pritmerive të shoqërisë për reformimin e sistemit të drejtësisë.

Presidenti i Republikës, z. Ilir Meta, shpreh keqardhjen për mosmiratimin e propozimeve të Ministrisë së Drejtësisë për shkarkimin e disa gjyqtarëve nga ana e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Presidenti i Republikës, z. Ilir Meta, që prej marrjes së detyrës si Kryetar i KLD-së, ashtu si dhe ditën e djeshme ka mbështetur në vijimësi të gjitha propozimet e Ministrisë së Drejtësisë (propozime të ish-Ministrave të Drejtësisë, apo Ministres aktuale Gjonaj) për procedimin disiplinor dhe shkarkimin nga detyra të gjyqtarëve, kërkesa këto aktuale, apo kërkesa të mbartura dhe të pashqyrtuara nga KLD-ja”.

Në krye të herës Ilir Meta nuk duhet ta kishte mbledhur fare KLD, meqë e

kishte aq merak këtë punë, pasi KLD praktikisht është e shuar dhe dihet se çfarë vendimesh do marrë. Aq më tepër që gjysma e anëtarëve kanë dhënë dorëheqjen nga Vettingu.

E dyta, Ilir Meta e kërkoj këtë mbledhje të KLD për të rikthyer në gjyqësor mikeshën e tij Shpresa Beçajn dhe për kompensim mbledhi KLD për të përfituar dhe ata gjyqtarët që duhej të ishin në burg, jo të qëndronin në sistemin e drejtësisë.

Prandaj nuk duhet të bëjë si “shpirt i keq” dhe të shesë ata që votuan “qokën” e tij për Beçajn por dhe mbajtjen e shkelësve të ligjit në gjyqësor, duke rrëzuar ministren e Drejtësisë

Redaksia



Teatri me Këshillin e Lartë të Drejtësisë

Nga Ylli Manjani,
ish Minister i Drejtësisë

Megjithë respektin, por as Presidenti i Republikës e aq më pak Ministri i Drejtësisë nuk kanë të drejtë të ligjërimit e tyre publike, pas mbledhjes së KLD.

KLD tashmë nuk ka asnjë ligj që ta mbajë në këmbë. Asnjë ligj nuk i jep të drejtë KLD së krijuar me Kushtetutën e vjetër, të marrë vendime sipas Kushtetutës së re (pas ndryshimeve)! Asnjë!

Për më tepër, edhe ligji i ri Për Statusin e Gjykatësve, është shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese (tashmë ndjesë pastë)!

Ministri i Drejtësisë nuk bën më as inspektime e as propozimet për masa disiplinore! Ska asnjë ligj më në fuqi që ta autorizojë këtë gjë.

Ndaj KLD që ka ngelë as emëron e as shkarkon dot asnjë gjykatës. Pavarësisht se gjyqtarët mund të jenë vërtetë për shkarkim, prap nuk ka ligj që të legjitimojë KLD ta bëjë!

Shkarkimi i gjykatësve pa ligj është aq anti-kushtetues!

Se bie fjala, nëse duhet shkarkuar një gjykatës për një vendim mase sigurie për një që kërkohet për ekstradim, pse të mos shkarkohet vetë Ministri për



një ekstradim haptazi të paligjshëm?!

Ndaj them se deklaratat e Ministres dhe Presidentit janë kot! Krejt pa lidhje dhe që nuk i justifikon asnjë ligj në fuqi!

E vetmja rrugë mbetet, rregullimi i ligjeve Tranzitore. Tja kërkojnë Parlamentit zgjidhjen e problemin dhe jo KLD që tashmë ska asnjë fuqi as formale e as substanciale!

Teatri me KLD është i papranueshëm! Nuk mund të "lahen duart" me amanetin e Marigosë, që t'i hedhin dhe ata që nuk i hodhën baltë...

Ish ministri Saimir Tahiri i foli "shelit" me gjuhë mafiozësh

Nga Grida Duma,
deputete e PD-së

Ne do bëjmë të pamundurën si PD, që qëndrimi ynë është pro hapjes së negociatave. Filozofia e ekonomisë së bashkuar vazhdon edhe sot. Çfarë duhet të bëjmë ne që qeveria të rrisë llogaridhënien që duhet t'i japë qytetarëve. Deputetët e Holandës kanë kërkuar që 5 prioritetet në Shqipëri të jenë tërësisht të aplikueshme.

Vetëm faqet e para të raportit janë motivuese, ndërsa faqet e tjera të progres-raportit janë të njëjta si në vitin 2016. Kemi notën 2.5, që do të thotë nën mesatare.

Dhe fakti që deputetët holandezë janë skeptikë, kjo do të thotë që s'jemi mirë me 5 prioritetet. I vetmi qëndrim që duhet të mbajmë është të shtyjmë Shqipërinë të hapë negociatat.

Shqipëria ka një problem madhor, ekonomia. Shqiptarët e vuajnë këtë në jetën e përditshme, në Ballkan jemi të fundit në çdo sektor. Ose nuk kemi asnjë sektor të vetëm që të themi që jemi konkurrues.

Jemi në dështim për aq kohë sa mbi 50% e shqiptarëve jetojnë me më pak

se 5 dollarë në ditë. As ndërgjegjësi nuk vlen në varfëri. Nuk luftohet varfëria me ndëshkime. Nuk ka zhvillim.

I pyet për problemet e tyre të qeverisjes, thonë e ka fajin opozita. Nëse i pyet për problem të shtetit, thonë e ka fajin PD. Nuk jemi ne në qeverisje. Përgjegjëse për hapjen e negociatave,

është vetëm qeveria," tha Duma.

Përsa i përket dorëheqjes së Tahirit nga mandati i deputetit, nëse do të ndikojë në hapjen e negociatave, deputetja e djathtë tha se ishte një vepër që duhet të ndodhte kohë më parë.

"Që ishte e shtrënguar kjo nuk diskutohet. Ne e dimë shumë mirë që nëse akuza të tilla vijnë nga organet

e hetimit të një vendi anëtar të BE, si Italia, e cila nuk hap çështje kot, kjo duhet të ndodhte me kohë.

Tahiri i foli "Shelit" me gjuhë mafiozësh. Tahiri është përdorur. Kemi parë kode mafioze në qeverisje. Dorëheqja mendoj se ishte lëvizje e vonuar.



Posta sekrete e Prokurorisë Durrës dhe “budallai” që mbush xhepin me letra

Populli e ha sapunin për djathë e mban barkun bosh nga të qeshurat, por këtu ka një ndryshim të vockël. Nëse hajduti i fabulës sonë ua hidhte sigurimsave, këta hajdutët tashti janë përballë amerikanëve e ndërkombëtarëve, ku kapjen e hajdutëve nuk e kanë sukses, por punë të zakonshme.

Nga: Sokol Pepushaj

Një hajdut xhepash në kohën e diktaturës komuniste, natën bënte hajdutin e ditën budallain. Të tërë kënaqeshin me të. E hanin këtë “kokërr ulliri” edhe punonjësit e Sigurimit të Shtetit.

Ai tërë natën, pasi bënte një maskim artizanal, dilte në radhë të qumshtit e të djathit e u fuste duart në xhepa hallexhinjve, por ditën dilte në lokal, porosiste një kafe dhe numeronte ca copa gazetash si bos.

E pyesnin njerëzit pse i numëron ato letra gazetash.

-Janë para, -thoshte e i fuste me kujdes në xhep.

Në fakt, budallenj ishin ata që gajaseshin me të, se ato letra, para ishin.

Këtë më kujton sot ngjarja në Prokurorinë e Durrësit. Hajdutët nuk vodhën para, por letra, vodhën dosjen sekrete ku kishte akuza për hajdutët. Njëri prej atyre në dosje, i takon të ketë qënë kryeprokuror me emër Deti.

Këtë here nuk kemi një hajdut që bën budallain e numëron letra, por kemi një kryeministër që bën “budallain” e para popullit numëron raste që “kap hajdutët e kriminelët”, prokurorë, gjykatës, rilindas.

Të tërë bëjnë budallain, e të tërë i kanë xhepat plot, njëllosh si ai hajduti i dikurshëm.

Edhe këta letra numërojnë.

E dëgjoni Edi Ramën kur shfleton letra për reforma, e thotë janë suksese, Presidentin kur shan hajdutët e numëron arritje mbi letra, ku nuk mjafton as një natë e gjatë dimri pranë oxhakut me dru Skrapari, ti kalosh, e thotë janë arritje.

E shihni Monikën si shfleton letra kundër burrit të vet, Saliun që grumbullon letra kundër Ramës, Ramën që shfleton letra kundër Bashës e Bashën me xhepin plot letra në Bruksel kundër Vettingut, e të tërë bërtasin se numërojnë ide, alternativa, objektiva,

shpresa...?

Në të vërtetë nuk janë thjeshtë letra, janë para e pasuri që i kanë marrë në xhepat e popullit tash 27 vjet, ndërsa tani tallin prapanicën me këtë popull

e bëjnë budallain, si ai hajduti i kohës së Enverit.

Populli e ha sapunin për djathë e mban barkun bosh nga të qeshurat, por këtu ka një ndryshim të vockël.

Nëse hajduti i fabulës sonë ua hidhte sigurimsave, këta hajdutët tashti janë përballë amerikanëve e ndërkombëtarëve, ku kapjen e hajdutëve nuk e kanë sukses, por punë të zakonshme.



Islami dhe shqiptarët

Psikanalisti i famshëm Karl Jung e krahason Hitlerin me Muhamedin a.s.

Nga Arben Çokaj,
Frankfurt am Main

...FEJA DOMINON NË SHKETET E DOBËTA, PASI SI PJESË E PUSHTETIT MBI NJERIUN, FEJA DHE SHKETI JANË NË KONTRADIKTË. SHKETET E FORTA I TREGOJNË VENDIN FESË, KURSE SHKETET E DOBËTA, GJUNJËZOHEN PARA SAJ. PRANDAJ NË SHOQPËRI TERRORIZOHENI TË GJITHË NGA THIRRJA E ZANIT, SE SHKETI ËSHTË I PJERDHUR. LIGJET DEMOKRATIKE NUK E LEJOJNË PRISHJEN E QETËSISË PUBLIKE DHE SHKELJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT, SIÇ NDODH NGA FEJA TEK NE. PËRZIERJA E PUSHTETIT ME FENË SJELL MOS-ZHVILLIM SHOQËROR. DIKUR FEJA E KRISHTERË ISHTE SË BASHKU ME PUSHTETIN NË EVROPË DHE PËSUAM MESJETËN. KURSE TANI PROBLEMI MË I MADH VJEN NGA ISLAMI, PASI AI ECËN ME PSIKOLOGJINË SOCIALE TË SHEKULLIT TË 7-TË...

Në një kohë të hershme, kur njohuritë e njeriut për tokën dhe universin ishin tepër të vogla dhe kur njeriu i lashtë habitej me dukuritë natyrore apo prejardhjen e vet, pyetja shpesh bëhej, nga e ka prejardhjen njeriu? Nga vjen, kush e krijoi? Dhe duke mos qenë i aftë njeriu i atëhershëm të gjente një përgjigje të agumentuar, ai gjeti mënyrën më të mire për të qenë i lumtur: gënjeu vetveten! Regjisori i njohur amerikan, Woody Alen, në një intervistë të tij të kohëve të fundit, ka gjetur formulën e lumturisë. Ai thotë se, “që të jesh i lumtur, duhet të gjesësh një gënjeshtër dhe të rrih duke mashtruar vetveten gjithë jetën!”

Duket se pikërisht këtu e ka zanafillën edhe feja. Një përpjekje e njeriut për të gënjyer vetveten, në një kohë kur njeriu nuk ishte edhe aq i ditur. Por Zigmund Frojd sqaron se me rritjen e intelektit të njeriut, edhe feja apo besimi fetar, do të vijë duke rënë.

Moisiu e mori emrin nga grekët, kurse në original, ai quhej Moses, i biri, në gjuhën egjiptiane. Muhamedi a.s. ia arabizoi emrin atij në Musa. Hazerti Musaja a.s. (aleisislam), ashtu si për Jezusin, hazerti Isaja a.s. Pra, Moisiu mbahet si themelues i fesë monoteiste, ndonëse besimi në një zot të vetëm lindi me Abrahamin. Për Moisiun thonë se ishte një fëmijë i vogël, i cili u gjet në një shportë zunkhi, të lyer me rrëshirë në lumin Nil dhe u shpëtua nga princesha e fareonit. Ai u rrit në familjen e fareonit, dhe periudha e kohës, kur u themelua edhe feja monoteiste nga Akenotek, zoti i diellit, ishte edhe koha kur besohej se zoti i tokës ishte dielli. Pas vdekjes së Akenotekut, pati rrëmujë në Egjipt, dhe Moisiu, një general i faraonit, i priu popullit hebre, i cili ishte popull skllav dhe u largua nga Egjipti. Dhe populli hebre, e pranoi Moisiun egjiptian si prijësin e vet, duke besuar edhe në fenë e tij, e cila u transformua nga feja e Akenotekut, prej besimit tek dielli, si zoti i tokës, tek besimi në një zot të vetëm. Kjo është pak a shumë edhe prejardhja e feve monoteiste nga Moisiu.

Është interesant fakti se Moisiu ka një histori të lindjes së tij, identike me Sargon Akkadin – themeluesin e Babilonisë së lashtë, 2800 vjet para Krishtit. Sargon Akkadi tregon në shkrimet e gjetura mbi rrasa guri, se atë e hodhi e ëma e tij në lumin Eufrat, në një shportë zunkhi të lyer me rrëshirë... Duke u nisur nga kjo, studiuesve të fesë, që e marrin fenë si fenomen shoqëror e jo hyjnor, u shkon

në mendje se këto histori janë manipuluar në atë mënyrë, për të gjetur përkrahjen e njerëzve, për të depërtuar sa më lehtë në nën-ndërgjegjen e tyre, për të kapur masat, dhe në këtë mënyrë për t'u mitizuar, për t'u bërë mitike.

krijuar një iluzion. Feja në vetvete hyn në ndërgjegje që fëmijë dhe i krijon individit dominancë, një shtet brenda kokës së tij – thotë Frojdi. Prandaj mendohet se është më mirë, që fenë ta marrin njerëzit kur të rriten, se në atë moshë kanë edhe mundësi

lemi më i madh vjen nga islami, pasi ai ecën me psikologjinë sociale të shekullit të 7-të. Nëse marrim parasysh faktin se Magna Carta – karta e parë e të drejtave të fisnikëve anglezë, u firmos nga mbreti anglez me 15 qershor 1215, merret me mend tani se sa të drejta ka patur njeriu në shekullin e 7-të, kur u shkrua Kur'ani. E përderisa Kur'ani që në atë kohë është i pandryshueshëm, dhe tenton edhe sot të bëhet model shoqëror, atëherë nuk ka dyshim që shoqëritë që ndjekin Kur'anin janë të destinuar të mbesin prapa. Shoqëritë islame i lënë edhe gratë pa punë, pa kontribut në të ardhurat publike. Dhe duke mbajtur mbi gjysmën e popullsisë pa kontribut në sektorin publik, shoqëria do të mbetet padyshim e prapambetur. Prandaj, mos u habitni shumë shqiptarë të nderuar, dhe sidomos ju që dashuron islam, se pse ne jemi kombi më i përçarë dhe më i prapambetur në Evropë. Ja ku e keni shkakun dhe përgjigjen.

Në një intervistë për një gazetar amerikan në vitin 1938, psikanalisti Karl Gustav Jung e krahason Hitlerin me Muhamedin a.s. nga pikëpamja e mitizimit të tyre për së gjalli. Jungu sqaron se diktatorë si Hitleri e kanë pavetëdijen e madhe dhe ata pasqyrojnë pavetëdijen e popullit të tyre, prandaj pavetëdija e tyre godet si megafon mbi pavetëdijen e çdo gjermani, ashtu siç synon të godasë feja islame me altoparlatet e eZanit të lartë mbi pavetëdijen e çdo myslimani. Duke shfrytëzuar shtetin e dobët e të pavetëdijshëm shqiptar, xhamitë shqiptare po lulëzojnë përditë, dhe përderisa nuk i ndalon askush, ato po bërtasin me ahengun arab, duke dhunuar edhe tolerancën fetare dhe respektin, që shqiptarët tregojnë për besimin e njëri-tjetrit. Pyetja është, po shkojmë drejt një shteti demokratik, apo islamik?

Nëse shoqëria shqiptare shkreteton në fe, ajo bëhet irracionale, humbet sensin e realitetit dhe merr tiparet e një vendi të pazhvilluar dhe problematik, ashtu siç ka qenë dhe është edhe sot. Shqipëria duhet të lëvizë drejt një shteti ligjor dhe të së drejtës dhe drejt zhvillimit ekonomik, krijimit të firmave të suksesshme shqiptare, investimeve private dhe hapjes së vendeve të punës. Vetëm kështu, ekonomia jonë mund të bëhet e shëndetshme dhe mund të shërohet e konkurrojë tregun. Dhe vendi e kombi ynë, mund të ecë përpara! Me punë!



Frojdi thotë: Feja është një neurozë obsesionale gjithënjëzore! Ndërsa Karl Jung vijon: “Fe do të thotë varësi nga irracionajja, nënshtrim i tij si realitet objektiv, e cila nuk përshtatet drejtpërdrejt me kushtet sociale dhe fizike, por që më shpejt përputhet me orientimet psikike të individit.” Dmth. Hyn më lehtë në ndërgjegje. Feja është infantilizëm, irracionale dhe përfaqëson pavetëdijen e njeriut. E megjithatë, njerëzit e paditur vazhdojnë të besojnë.

Kafshët janë pavetëdije, ato jetojnë në vath me kashtë. Prandaj edhe hyu lindi në kashtë... si rrjedhojë për të ndikuar pavetëdijen e masës dhe për t'u bërë sa më i besueshëm për masat e paditura. Pse nuk lindi hyu në një tempull, apo pallat? - pyesin psikoanalistët Frojd e Jung! Konkretisht, po citoj Jungun: “Pavetëdija pranohej thjeshtë si natyrë e kafshës, nëse kjo nuk është një grumbullim i mosfunksionimit të ndërgjegjes... Njeriu masiv i pret emocionet e tij në grumbullimet masive... Fetarët orientohen nga këto dhe e pranojnë këtë çmenduri!” Jungu - djali i një pastori gjerman - mendon në vetvete, se feja ka një ndikim psikik mbi njerëzimin, është një trashëgimi kulturore, sidomoftë, ndikon mbi pavetëdijen e njerëzve, duke

të zgjedhin...

Një nga fenomenet më kontradiktore të trajtesës psikologjike e psiko-analitike të fesë nga Frojd & Jung është edhe fenomeni i “vrasjes së t'atit”, i cili si duket u theksua më shumë me Niçen (Nietzsche). Vrasja e të atit, dmth. psikologjikisht, vrasja e autoritetit të babait – çuditërisht, i kemi të gjithë ashtu, Moisiun pa baba, Jezusin gjithashtu, por edhe Muhamedin a.s. jetim. Në Evropë, kjo ka ndodhur nga pikëpamja shtet-formuese, pasi ligji qëndrom mbi të gjithë dhe asnjë individ nuk ka autoritet dominant mbi shoqërinë, përveç ligjit. Kjo ka sjellë zhvillimin e shoqërisë. Ndërsa feja dominon në shtetet e dobëta, pasi si pjesë e pushtetit mbi njeriun, feja dhe shteti janë në kontradiktë. Shtetet e forta i tregojnë vendin fesë, kurse shtetet e dobëta, gjunjëzohen para saj. Prandaj në Shqipëri terrorizohemi të gjithë nga thirrja e Zanit, se shteti është i pjerdhur. Ligjet demokratike nuk e lejojnë prishjen e qetësisë publike dhe shkëlqen e të drejtave të njeriut, siç ndodh nga feja tek ne.

Përzierja e pushtetit me fenë sjell moszhvillim shoqëror. Dikur feja e krishterë ishte së bashku me pushtetin në Evropë dhe pësuam Mesjetën. Kurse tani prob-

Përse Enver Hoxha e fshehu bashkëpunimin e letërkëmbimin me gazetën Illyria, në 7 mars të vitit 1936?!

(GJARPËRI E POLIAGJENTI I PAPËRGJEGJSHËM FSHEH KËMBËT. SEKRETI, "THEMBRA E AKILIT" QË I KA SHPËTUAR EDHE BIOGRAFISTIT BLENDI FEVZIU)

nga Agron Luka

"Prezantimi i Enver Hoxhës, si korespondent gazetar i L'Humanité dhe betimi si komunist", para Pol Vajan Katurie, në Paris më 1936!

Mënyrat dhe metodat e Enver Hoxhës, i ndihmuar edhe nga bashkëshortia e tij N. Hoxha dhe nga një tufë servilësh e falsifikatorësh historianë, për t'u futur e prezantuar në histori, me biografi sa më suprizuese, për të akaparuar e vendosur kultin gjëniale e vendimtar të individit në të gjitha momentet e evenimentet e mëdha historike shqiptare e madje edhe botërore, duket se ka nevojë ende të çmontohet, të demaskohet e të demistifikohet. Këtë detyrë, jo vetëm e kërkon e vërteta historike, por edhe rreziku i imitimit në pluralizmin dhe tranzicionin e brishtë shqiptar.

Abicijen, për tu dukur si individ i shquar, Enveri, sa duket e ushqeu fillimisht nga imitimet e Rilindjes Turke, nga heronjtë si Enver Pasha dhe Kemal Attaturku. Pak më vonë do të imitonte edhe disa shembëlltura të Naltmadhnis Tij Ahmet Zog I Mbreti i Shqyptarve. Koloneli 17 vjeçar, na e pretendonte vehten se, na kishte luftuar pothuajse rolin vendimtar qysh nga dita 28 nandor 1912 e Shpalljes së Pamvarësisë. Një analist si Blendi Fevziu, e ka quajtur këtë lloj loje e roli të Zogut I, **si një interpretim e kombinim i shkëlqyer i diplomacisë së vjetër anadollake.**

Vitet që pasuan treguan se, Enveri e tejkaloi Zogun I, me shumëfisha, si diktator, si hipokrizi-diplomaci e vjetër anadollake dhe si ambicie skicofrenike deri edhe si Pejgamberi e Khalifi M-L i Botës! Duke shfrytëzuar me mjeshtëri tabanin injorant orjental dhe përkushtimin e rinisë shqiptare për përparim modern, ai e çoi diktaturën, eliminimin fizik e psikik në funksione të kultit të personit të tij, në nivele të pa imagjinueshme.

Me maninë e sëmurë për t'i parakaluar të gjithë, me nepsin e xhelozinë pangopur (retrospektivisht vetëkuptohet), synonte gjithmonë të ishte ai personalisht i pari deri edhe në vogëlsira. Prof. Sejfullah Malëshovën, Enver Hoxha e ka luftuar duke nxitur edhe disa intrigantë të tjerë, pikërisht sepse e kishte zili, kishte cmirë e xhelozitë të jashtëzakonshme, sepse ai i njihë, i kishte lexuar dhe ishte përkthyes i shquar i veprave marksiste.

E. Hoxha, improvizonte se e kishte lexuar "Manifestin e Partisë Komuniste" në frengjisht, dmth me frengjishten që kishte mësuar në Gjirokastër dhe në vitet e para të Liceut në Korçë, kur punëtori Koci Bako ia dhuroi atë rastësisht së bashku edhe me një pastë, falas! Po ashtu na kish lexuar edhe në Francë, frengjisht "Antidringun" etj.

Kur binte diskutimi, ose shkruhej në biografitë e disa komunistëve të "Organizatës Komuniste të Shqipërisë"/ ose "Grupit të Shkodrës", se ata kishin patur, kishin lexuar e kishin

përkthyer e shaptilografuar shqip, Direktivat dhe Raportin e Kongresit VII të Kominternit, se kishin botuar shqip këtë apo atë vepër marksiste, përfshirë edhe Manifestin e Partisë Komuniste, Enver Hoxha për njëherësh do kërcente si, "ti ngulej bizi në b..." dhe niste të improvizonte gënjeshtër, shpesh duke sajuar e komprometuar dëshmitarë të vdekur e të gjallë.

Mbasi i kishte eliminuar pothuajse të gjithë grupin e komunistëve të themelimit dhe shumë të tjerë të shquar, bashkë edhe me Koço Tashkon ndër të fundit, E. Hoxha, duke ia faturuar këtij disa nënkuptime spiunimesh, nisi të improvizonte romanin letrar "Kur lindi Partia, Kujtime", ku nxirrte vehten si truri, kontribuesi e themeluesi kryesor. Ky libër përfaqëson një masakër dhe një fallsifikim makabër në të gjithë historinë e të majtës shqiptare.

Në vitet e para mbas çlirimit E. Hoxha mbahej praktikisht si ish komunist i vjetër dhe si teoricien marksist-leninist, por nuk ishte ngutur nga "modestia" ta përshkruante me shkrim aktivitetin e tij të hollësishëm.

Historia e Enverit, mbas disa medemek leximeve intensive në liceun e Korçës, mbas parapregatitve e kurseve teorike marksiste në Montpellier dhe në qendrat e leximit të P.K. Franceze, na dilte se na ishte kurorëzuar si komunist me një tip provimi dhe betimi zyrtar e solemn brenda në Paris, më 1936.

Mbasi ia kishte nxjerrë sapaq kokën, se na kishte qenë ish simpatizant i P.K. Franceze dhe si korespondent i gazetës L'Humanité, me anën e disa "kujtimeve retrospektive", te Historia e PPSH, 1968, f 59, më në fund "Enveri Ynë", e bëri kabull dhe ia shpalli popullit edhe një tip monolog-dialogu, para një personi francez komunist të quajtur Pol Vajan Katurie (Paul Vaillant-Couturier):

- Unë jam komunist me gjithë shpirt, partia shtypi juaj dhe mjerimet e popullit tim më kanë bërë komunist. Ndonjëherë, nga lajmet që mund të marr nga Shqipëria, a mund të dërgoj në "L'Humanité" nga ndonjë artikull të vogël për të demaskuar regjimin feudal të Zogut?

- Posi, të dërgoni, shok, do t'jua botojmë me gjithë qejf. ...Frëngjishten e flisni mirë, por duhet edhe ta shkruani. Për çdo artikull që do të na dërgosh, vuri pseudonim. Shkrimet që do të na vijnë nga Brukseli e që do të flasin për Shqipërinë do të kuptojmë se vijnë nga ju shoku Hoxha. Ta duash dhe të luftosh për komunizmin, - më tha Vajani.

- Deri në vdekje do të luftoj! - i thashë ("Vite të Rinisë", bot. 1988, f 199-200)

Si garanci e provë autenticiteti se, e kishte takuar atë burrin Pol Vajan Katurie, E. Hoxha jepte vetëm përshkrimin: **"një mesoburrë, me fytyrë të qeshur e sy të qeshur, por që egërsoheshin kur fliste për fashizmin".**

Vini re me vëmendje betimin e Enverit, se do të luftonte deri në vdekje

për komunizmin, por nuk thoshte se ishte i gatshëm edhe për sakrificën sublime. Këtë temë, ai ia kishte kopjuar Pol Vajanit. Vajani shkruante edhe për sakrificën sublime me jetë, për mbrojtjen e komunizmit, kundër rrezikut nazifashist. Ndërkaq po të dëgjosh përshkrimet letrare të E. Hoxhës, me të cilat rrekej t'ia kalonte si talent edhe Ismail Kadarese, na del se Hoxha ynë, më shumë se sa mjerimet e popullit shqiptar, fillimisht na qenkesh bërë si komunist, për të siguruar jetesën si parazit, për të siguruar ca franga për të mbushur barkun e uritur me bukë e me gjellë e nuk ndalej para asnjë lloj poshtërsije.

Dhe, ndërsa Hoxha ynë me kujtesë fenomenale, rrëfente kështu "Betimin para Vajanit", nga ana tjetër nuk e quajti të arsyeshme të paktën t'ia linte historisë: **Cili ishte ai muaj e ajo datë fatlume, cilët artikuj i dërgojte Humaniteja nga Brukseli, si, "lajme të marra nga Shqipëria apo si krijime autentike të tij"; si ishin ato pseudonimet dhe qysh kur dhe me cilin organ a person në Shqipëri, na kishte vendosur korespondenca dhe bashkëpunime gazetareske!**

Shikojeni dredhinë e paramenduar të Enverit, për të kapur të gjithë artikujt anonimë me tema nga Shqipëria!

Vizitën tek redaksia e gazetës L'Humanité, tek vetë selia e P. K. Franceze dhe për disa episode takimesh të personave të ndryshëm shqiptarë me personalitete të ndryshme të komuniste e socialiste franceze, E. Hoxha bashkë me të shoqen, jo vetëm e kishin dëgjuar gojarisht, por edhe kishin patur rastin ta lexonin, në disa nga biografitë e paraqitura, nga militantë e komunistë shqiptarë. Por, askush nga ata, nuk thuri lavde, gënjeshtër e përvehtësime kaq spektakolare si Enver Hoxha.

Me këto tipe vetëdeklarimi të improvizuara, të cilat nuk mund të verifikoheshin, E. Hoxha, e deklaronte veten intelektual me shkollë, me lexime autodidakte qysh herët, plus edhe ca kurse speciale filozofike në Byronë Politike, (shih, në Veprat 15 e 1 8, me f. 287 e f. 157, shënuar qysh në hapje nga babai im Gj. Luka, "Mbi Intelektualizmin")

Gj. Luka, babai im, megjithse nuk kishte mbaruar shkollë të lartë, ishte në grupin e lektorëve pranë Agjitpropit, në KQ të PKSH. (Gj. Luka, u përjashtua nga shkolla në kohën e Zogut I, për shkak se ishte marrë me ideologji komuniste, se kishte blerë, kishte kontribuar dhe organizuar teknikën e O. K. Shqipërisë, duke botuar edhe "Manifestin e Partisë Komuniste" etj. Ai ishte arrestuar nga policia zogiste, qysh në dhjetor 1938 dhe ishte dënua me burgim nga regjimi zogist në gjyqin e shkurtit 1939. Pak muaj më vonë ishte ripërjashtuar edhe nga të gjitha shkollat e Imperos dhe dënua me vdekje në mungesë nga fashizmi... AL).

Në disa raste të veçanta në KQ. të P.P.Sh. dhe në Shoqërinë e Miqësisë Shqipëri-BRSS, organizoheshin

disa tema për njohjen e partive dhe personaliteteve komuniste europiane perendimore si P.K.I. dhe P.K.F., pastaj edhe amerikano-latinë etj. Në to asistonin shpesh edhe anëtarë të Byrosë Politike, përfshirë edhe vetë Enverin. Në një rast, po flitej për P. K. Franceze, për ndikimin dhe shtypin e saj që gëzonte një popullaritet të madh. Gjovalini po tregonte edhe një eksperiencë personale mbi vajtjen e tij te selia e PKF. Ai kishte cituar Pol Vajan Katurie në një shkrim të vitit 1936, ku flitej edhe për shokun Gabriel Péri. Aty shkruhej se, komunistët duhej të sakrifikonin deri në vdekje për komunizmin, për rritjen e rrezikut nazist etj dhe kishte lexuar edhe një vjershë për Vajanan, me përkthim shqip direkt nga frëngjishtia. Mbas mbarimit të aktivitetit, Enveri e ndali Gjovalinin, shumë i kuriozuar e pyeti:

- More Gjovalin, po ç'ne që ti na paske vajtur edhe te redaksia e Humanitesë edhe në selinë e PK Franceze, në Paris? Si ka mundësi, më ke habitur?!

- Po, ja shoku Enver, ne kemi shkruar qysh në moshë të re sidomos në Itali, në Francë disa herë. Kam qenë edhe në Belgjikë... Shoqia Nexhmije i ka ditur...

Vonë e vonë e kuptoi qartësisht Gjovalini se, ku na kishte qëndruar hileja e madhe. Tashmë ai po e paquante edhe sinqeritetin e treguar. Padashje e rastësisht, ai kishte shkelur në kallo, kishte prekur në boshllëkun e xhelozinë që kishte Enveri, sepse ai ishte pa asnjë lloj aktiviteti, as si simpatizant, as si militant e as si komunist. Ai kishte bërë emër vetëm nga mbështetja që i kishte dhënë Koço Tashko e familia e tyre, pastaj edhe Vasili e jugosllavët me Milladinin e Dushanin...

"Të çduket nga qarkullimi për dy javë Migjeni", me komentet e Gjovalin Lukës!

Në materialet e mbetura të babait tim (disa lidhen edhe me botimin "Migjeni, VEPRRA, Mbledhje dhe shpjegje nga Gjovalin Luka", N. SH. B., Tiranë, 1954), ndër të tjera ruhen edhe disa fletë të daktilografuara e disa në manuskript, me pjesë plotësime, citime e komentime të ndryshme.

Me sa kuptohen, Gjovalini pregatitej t'i kthente përgjigje një Kritike, të dërguar të daktilografuar nga ana e L. SH. SH., dhe redaksia e revistës Nëndori, aty nga fund prilli i vitit 1954. Ekspertët **kritikonjës** në fakt ishin të deshifrueshëm, por aty ruhej një farë anonimat, duke u maskuar si një artikull kritik redaksional, si me thënë. (Fjala ishte për "Kritikë e Bibliografi", që do të botohej pastaj te revista Nëndori, Nr. 5, 1954)

Po tek ai numër reviste kishte edhe disa kritika direkte, nga disa njohës bashkëkohorë të Migjenit...

Gjovalinin e informuan se redaksia e revistës Nëndori ishte urdhëruar që "Përgjigjigje Kritikës" nuk do të botohej, por ai mundej t'ia dërgonte

redaksisë shkrimin e tij në formë autokritike dhe kjo mbase do të diskutohet në ndonjë mbledhje të L.SH. Sh. Megjithse Gjovalini e kishte autoçensuruar vehten në maksimum, Përgjigjigje e tij, nuk u botua aso kohe. (Ne e kemi botuar tashmë atë dhe gjendet edhe në internet)

Më konkretisht, që t'i biem sa më shkurt, në letrat për vjershën "RECITAL' I MALSORIT", bot. në Illyria, 7 mars 1936, ndodhet edhe një fletë me një shënim mjaft enigmatik, në anën e pasme, ku shkruhet:

Mendoj se Migjeni, po të botohet simbas rendit kronologjik, na jep mundësinë me analizue edhe ma qartë oshilacionet e evolucionin e tij. Unë e kam ndjekë Migjenin në të gjitha botimet origjinale të publikueme në shtypin e kohës, por tue konstatue se aktualisht ka polemika mjaft inkandeshente, jam kufizue sa ma strict.

(Në atë numër, gazeta Illyria, 7 mars 1936, asht edhe një korespondencë, që pretendohet e botueme, e dërgueme nga E. Hoxha, Bruxelles!)

Dikush si F. Gj., në konfidencë, qysh kur libri kishte shkruar për shtypshkrim, fillimisht i kishte treguar Gjovalinit, se, E. Hoxha kishte kërkuar t'i dërgohen disa dorëshkrime origjinale të poezive e prozave të Migjenit dhe kishte këshilluar të hiqen nga botimi i Gjovalinit, disa copa letrare nga të Migjenit, megjith komentet e tyre, si ..., sepse kanë disa mishra të huaja...

Po ashtu, në konfidencë ia kishin treguar edhe urdhërin gojor të Enverit, aty nga fund viti 1956: **"Të çduket nga qarkullimi për dy javë Migjeni, me komentet e Gjovalin Lukës"!**

Ka vjet që unë e kam shuar kurreshtjen time se çfarë na kishte qenë ky shënim amanet në kllapa i Gjovalinit, kjo korespondencë e Enver Hoxhës, ky alamet peshku, marshallah! Por kam pritur, si të thuash një më bilbil se unë...

As më pak e as më shumë, redaksia e gazetës Illyria, te rubrika POSTA, f 8, i kthente përgjigjen shokut bashkëpunëtor Enver Hoxha, diplomat nga Brukseli, dhe e lajmëronte se ia botonte në po atë numër, 7 mars 1936, korespondencën e tij e cila supozohej se ishte përkthimi nga frengjishtia, "Jacques Bainwille, "Diktatorët, Z. Attaturk ase Mustafa Qemali", f 4. (shihni fotoskanimet e nxjerra nga origjinali i Bibliotekës Marin Barleti dhe i M. H. Shkodër)

Ka patur përfolie aso kohe se, Enver Hoxha këtë përkthim ia kishte përvehtësuar dikujt tjetër; se, ka patur edhe polemika etj, por gjithsesi ky konspiracion kaq i pazakontë, duhet ndriçuar e analizuar, dhe e vërteta lakuriqe duhet të dalë! Dhe përfolie ka patur edhe për marëdhëniet e relacionet e Enver Hoxhës me ish dashnoren e Migjenit...

Mbasi i kulloti mirë e mirë rrethet zogiste e komuniste, E. Hoxhës i duhej të kthehej në atdhe. I mbetur pa diplomë e pa punë, ai filloi të frekuentonte rrethet e pakënaqura e kritizere

filo-fashiste, madje arriti edhe të hipte me ta edhe te Ballkoni i Bashkisë Shkodër, por kjo është një histori me vehte, që do ta trajtojmë në një numër tjetër.

Na vjen mjaft çudi se si biografistëve e analistëve të Migjenit, një ish lexuesi e kritiku rektifikues të Illyrisë & vazhduesve botues trashigimtarë të tij të veprës posthume; pastaj analizuesit të imtë, dr. Moikom Zeqos (i cili i kishte patur edhe privilegjin për të konsultuar disa nga dorëshkrimet origjinale të Migjenit, në Arkivin K. Q. të P. P. SH.); e më në fund biografistit të Enver Hoxhës, Blendi Fevziut,

kanë shpëtuar gjithato vogëlsira... Në disa letërkëmbime qoftë me Illyrian, me Minervën, me vetë botuesin Ismail Mal' Osmani edhe me Botën e Re, Migjeni ishte ankuar me shkrim për disa gabime, qortime e deformime teksti. Letër këmbimi i Migjenit me botuesin Ismail Mal' Osmani ekziston dhe ne e kemi botuar. Po ashtu gjenden përgjigjet e redaktive të gazetave, për ankesat e Migjenit. Pse nuk u botuan ato nga kritika e analistët e Migjenit?!



Por, cilat ishin ato gabimet tekstuale e ortografike dhe sa e ndryshonin ato Migjenin original në

manoskript e kopje daktilografim, nga tekstet e botuara? Kjo ishte një detyrë e një komisioni kolektiv redaktorësh ekspertë dhe jo detyrë e një individi. Si çuditërisht i ashtuqajtur si "Babai ose Dekani i Migjenologjisë" më 1956-1957, mos ndreqiet, mos redaktimin dhe mos botimin e saktë, ia kishte rrasur arbitrarisht, **redaktonjësit të botimit 1954!** Paradoxalisht, ky shoku tashti për herë të parë, pretendonte se, po përdorte disa tekste manoskrite posthume, të ndryshuara, korigjuara e redaktuara, me anëshkrime etj, nga vetë Migjeni në Itali, të cilat i kishte sjellë nga Italia

nga dr. Jakov Milaj. Ndërkohë, që ato manoskrite të Migjenit, ishin mbajtur në Syndyk dhe vetëm më 1956-1957, po lajmëroheshin për herë të parë, pretendohet që Gjovalin Luka duhej t'i kishte njohur! Por, si mund t'i kishte njohur, kur asnjë studiues nuk i kishte njohur e konsultuar?! Sa ndryshime tekstuale kishte Migjeni i 1954 me atë të 1957? Pse nuk u bënë disa nga ato ndryshimet tekstuale, që i propozonte bie fjala ajo Kritika e Nëndorit, Nr. 5, 1954?! Sa ishin të vlefshme komentet dhe analizat realiste të Gj. Lukës? Aq shumë i kishte djegur Enver Hoxhës, sa vendosi ta shumëzonte me zero

botimin e vitit 1954 dhe vetë personin ta torturonte e akuzonte me gjithfarë akuzash ultra ekstreme, madje edhe të pa shembullta...


Ndërkaq, dikush qysh nga viti 1954 ankohej se, nuk kishte studime e krahasime tekstologjike etj, dhe për një çudi (edhe turp) më të madh akoma na thuhet sot se, ky studim nuk është kryer! Ka edhe një problem tjetër. Kur një autor e boton si prodhim letrar një letër të fondit epistolar, në kohën e botimeve, ky hyn në prodhimin letrar. Por, kur fondi epistolar, mbetet intim, si rregull ky botohet më vehte dhe jo si prodhim letrar.



Materiale të shfrytëzuara nga Gjovalin Luka, për përkujtimin e Pol Vajan Kuturisë

Botimi i vjershës së Migjenit, nga Illyria, 7 mars 1936

Tregon gjëkafshë ky publikim i Illyrias?!



Redaksia e gazetës Illyria. 7 mars 1936, i kthen përgjigjen korespondentit Enver Hoxha

Botimi që mendohet si përkthimi nga Enver Hoxha

Shikoni dhe lexoni vetë se kush e qortonte Migjenin...



Operohet gabim në Zvicër, spitali përpigjet të falsifikojë dokumentet, tentojnë edhe ta vrasin që të mos flasë.

INTERVISTË E ISMAJL QERIMIT NGA VUSHTRIA E KOSOVËS DHËNË GAZETARIT TONE ARBEN LAGRETA

Ismajl Qerimi nga Vushtria e Kosovës flet për dramën e shumëfishtë që po përjeton që prej afro një dekade, ku pas një aksidenti në punë, u operua në mënyrë joprofesionale dhe për më tepër pa praninë e specialistit anestezi. Kjo ndërhyrje kirurgjike rezultoi e pafalshme sipas specialistëve që e vizituan më vonë. Kushdo që e ka lexuar romanin "Rrethi i kujtesës" të Diana Cullit, do t'i duket më normale eksperimentimi me medikamente që i bëhej në një klinikë naziste një partizaneje shqiptareje në vitet e Luftës së Dytë Botërore në raport me kalvarin dhe privimeve që ka hequr dhe vazhdon të vuajë Ismajli në vitet '2000. Sepse, si për ironi të fatit, Ismajli nuk jeton as në Ruanda, as nën regjimin e Mugabesë dhe as në ndonjë republikë të humbur bananesh por në zemër të Europës. Në një shtet që po i afrohet 800-vjetorit të formimit të tij dhe konsiderohet si model në funksionimin e demokracisë në shkallë botërore. Pikërisht në Konfederatën e Zvicrës.

Zhënjimi i tij më i madh do të vinte më pas si pasojë e diskriminimit, antihumanizmit dhe presioneve që ka përjetuar për të mbyllur gojën dhe për të mos ta publikuar këtë skandal. Historia e tij e dhimbshme është e vështirë të përshkruhet nëpërmjet një interviste sepse ai po vuan familjarisht pasojat e papërgjegjshmërisë së bluzave të bardha si dhe të përfshirjes së tyre indirekte në presione me qëllim për të heshtur për këtë skandal. Ismajli rrëfen me një kujtesë të admirueshme fakte dhe detaje, të cilat vërtetohen nga dokumentet origjinale që ai posedon dhe m'i vë në dispozicion. Në këto kushte arrita që të bindesha plotësisht se këtu kemi të bëjmë me një skandal, pavarësisht faktit se me të komunikoj ende nëpërmjet internetit on-line dhe jo drejtpërdrejt. Në kushtet e një dëshpërimi dhe ankthi të tejshkëlqës që ai ndien cdo ditë jo aq për vete se sa për pasigurinë e familjes së tij, Qerimi i është drejtuar tashmë Gjykatës Europiane të Strasburgut ku edhe ka depozituar dosjen e çështjes së tij me të gjitha provat, pas zvarritjeve përtej afateve ligjore të parashikuara nga Gjykata e Kantonit të Vaudit. I dëshpëruar për nëpërkëmbjen që po i bëhet në Zvicër, Qerimi thotë se në rast se e drejta e tij nuk do të shkojë në vend shumë shpejt ai do të fillojë familjarisht një grevë urie përpara një prej institucioneve kryesore të shtetit ose atyre ndërkombëtare të instaluar prej shumë kohësh në Zvicër. Pasi informohesh dhe komunikon me Ismajlin për kalvarin e vuajtjeve të tij të njëpasnjëshme si dhe shkaktarët të cilët ai i akuzon direkt, atëherë kushdo mund të kuptojmë më mirë ekzistencën në shtetin helvetik të frymës raciste antishqiptare, e materializuar kjo vitet e fundit me monstra të tipit Carla del Ponte apo Dick Martin.

Ndërkohë Qerimi shprehet i gatshëm që të përballë me cdo gjykatë në lidhje me pohimet dhe akuzat e rënda që ai ngre në këtë intervistë, madje duke u vënë në dispozicion që t'i nënshtrohet edhe provës së makinës së të vërtetës, ashtu si në SHBA/ Dhe, në mbyllje të këtij prononcimi, duke konsideruar si më efektive dhe më me peshë në arenën ndërkombëtare institucionet e shtetit shqiptar në raport me ato të Kosovës, ai i bën thirrje për ndërhyrje në përmjet autoritetit shtetëror dhe kanaleve diplomatike edhe Kryeministrit të Shqipërisë.

Nisur nga kjo situatë emergjente e Qerimit, në një nga aktivitetet me karakter politik ku isha i ftuar në Tiranë gjatë këtij muaji më rastisi që të prezantohesha me Zëvendësryeministrin e Parë të Kosovës dhe Kryetarin e AKR-së zotin Behgjet Pacolli si dhe Zv/Kryeministren tjetër, znj. Mimoza Kusari. Nisur nga fakti se z. Pacolli ka edhe nënshtetësi zvicerane por edhe një ndikim më të fortë se një politikan i zakonshëm fale aktivitetit të tij të suksesshëm si biznesmen në shtetin helvetik, i fola shkiurt me aq pak kohë sa kisha mundësi në atë ambient me njerëz në hotel Sheraton, problemin akut të bashkatdhetarit Ismajl Qerimi. Zoti Pacolli reagoi pozitivisht sepse i kisha shkruar për këtë problem një deputetëje të partisë së tij...

Kush është Ismajl Qerimi, kur erdhët në Zvicër, për ç'arsye dhe si u integruat?

Në radhë të parë ju falenderoj për mundësinë që po më jepni për të komuni-



kuar me publikun nëpërmjet kësaj interviste. Quhem Ismail Qerimaj dhe jam nga Dumnica e Vushtrisë në Kosovë ku edhe kam lindur më 1975. Lashë Kosovën në vitin 1992 për arsye politike si pasojë e shtypjes dhe e represionit të atëhershëm dhe në vitin 1993 kam ardhur në Zvicër ku më priste vëlai im i cili kishte emigruar më parë. Pas një viti fitova statusin e refugjatit politik dhe u vendosa në kantonin e Vaudit. Gjatë këtij viti u integrova mjaft mirë profesionalisht dhe u vendosa këtu përfundimisht. Në vitin 1997 u njoha me Isabela Pereira, një vajzë e mrekullueshme me nënshtetësi franceze dhe origjinë portugeze, me të cilën edhe u martova në vitin 2000 dhe kemi një djalë 8 vjeçar, Adrin. Unë fillova punë në postin zviceranë ndërsa bashkëshortja ime ka punuar menaxhere biznesi në lavanderi.

Tani le të ndalemi në aksidentin që ju ndodhi në punë. Si ndodhi?

Aksidenti ndodhi më 26 nëntor të vitit 2003 kur një pako me peshë afro 30 kilogram më ra në dorën e majtë nga një lartësi prej 4-5 metra. Shefi me dërgoi urgjentisht në Poliklinikën Vidymed në Lozanë. Dy mjekët më kanë kontrolluar, Dr. Moeri dhe Dr. Stuzenegger, të cilët, me anë të radiografisë, gjetën lëndim të damarit të syrit dhe të një kisti palmaire radiale (një lloj palme muskulore). Nga kjo ditë kam ndërprerë punën duke marrë ilace kundër dhembjeve. Në mes kohës, gjatë përcjelljeve mjekësore, më është dhënë një injeksion për të m'i ndaluar dhimbjet në dorën e majtë, gjë që më ka mundësuar që ta rifilloj punën në shkurt të vitit 2004. Kështu, pas disa muajve, Dr. Moeri dhe Dr. Stuzeneger, më sugjeruan që t'i shtrohesh një ndërhyrje kirurgjiale, i cili mu

bë më 22 shtator 2004 në klinikën La Source. 3 ditë para operimit më komunikuan pushimin nga puna...

Gjatë bisedës theksuat disa herë se ky operacion rezultoi fatal për juve. A mund të na shpjegoni në mënyrë më të kuptueshme për lexuesin se ç'farë ndodhi me ju?

Në cdo operacion pacientit i mundësohet prania një mjeku anestezi por kjo nuk ndodhi me mua. Unë jam vendosur direkt në sallën e operacionit dhe një infermiere erdhi për të luajtur rolin e anesteziestes. Këtë e vërteton edhe deklarata e firmosur nga mjeku i amnestezisë Dr. Pierre Ledermann, i cili, në dënimin profesional të kësaj ndërhyrjeje të papërgjegjshme kirurgjike ndaj meje, pohon se nuk ka qenë i pranishëm në operacionin tim, cka dhe është e vërtetë. Prandaj edhe vendosja e emrit të Dr. Ledermann si i pranishëm në protokollin e hartuar nga ana e Stuzenegger dhe mosvendosja e emrit të infermierës Sabine Noel e cila në të vërtetë e zëvendësoi atë, ka qenë një tentativë e pastër për të falsifikuar dokumentet. Kjo për arsye se Stuzenegger ka qenë i ndërgjegjshëm se zëvendësimi i një mjeku anesteziest me një infermiere në sallën e operacionit përbën një shkelje të rëndë ligjore. Ju keni në dispozicion edhe dokumentin e këtij protokollit që vërteton këto që sapa ju thashë. Vetë mjeku anesteziest Pierre Ledermann duke mohuar me anë të një deklarate të firmosur pjesmarrjen e tij në operacionin tim, më dhanë ushqim artificial-infuzion dhe pastaj Morphine. Neurologu deklaroi se është i panjohtuar për këto simptome dhe kërkoi ndihmë e shefit neurologjik për sëmundjen algoneurodystrophie. Pas shumë orvë pritje, më në fund arriti neurologu, i cili pas ekzaminimit, konsatton se gjendja ime ishte tejet e komplikuar dhe nuk ka mundësi të më ndihmojë. Ai më sygjeroi që të shkoj në banesë duke më premtuar se, në konsultim me kolegët e vet, do të bëj të mundshme një egzaminim më të përsosur. Por kjo nuk ndodhi dhe as që ka ndodhur deri më sot.

Si rodhën ngjarjet pas kësaj operacioni?

Që nga ky operacion shëndeti dhe jeta ime pësuan një traumë fizike dhe psikike. Nga dhembjet u detyrova menjëherë pas operimit që të kërkoj ndihmë mjekësore në urgjencë, ku për të dytën herë, më kanë aplikuar morfinë kundër dhembjeve, dhe aty mjekët më thanë se duhet të konsultoj kirurgun tim sepse këto dhembje nuk janë normale. Pas konsultimeve me Dr. Stuzenegger, shkova te Dr. Huggenbuhler, i cili më bëri ekzaminim EMG, i cili konstato se nuk ka përmirësim. Kirurgu im, kësaj here, më propozoi një riperim, duke dyshuar se operimi i nervit carpien ishte gabim, por duke u arsyetuar se duhet konsultuar sigurimin e aksidenteve, SUVA (Sigurimi Aksidental Profesional në Zvicër) për ta përcjellur gjendjen shëndetësore, gjegjësisht të dorës sime. SUVA më propozoi një klinikë speciale për riaditim në Sion... Në këtë klinikë, iu jam nënshtruar seancave fizioterapive dhe ergoterapive të papërshtatshme të cilat më kanë dëmtuar duke ma paralizuar grushtin të cilin nuk kam

mundur ta hap. Duke u përpjekur që të ma hapin grushtin, ata kanë praktikuar shumë infiltrime injeksionesh në muskuj (si Calcitonine, Botoxe e Redia), por që nuk kanë pasur asnjë sukses. Mjekët e SUVA-s nuk e kanë marrë seriozisht gjendjen time shëndetësore, madje ata më kanë quajtur stimulus (!!!). Për injorimin e shërimit tim, nga ana e mjekëve, i kam njoftuar edhe anëtarët e familjës sime. Unë kam insistuar me këmbëngulje se përse më mbajnë, të mbyllur si një jetim, duke më keqtrajtuar me sjelljet e tyre vulgare dhe agresive... Pas insistimit tim për kontrollin më profesional, ata më në fund ranë në përfundimin se diagnoza ime ishte "algoneurodystrophie". Mjekët më thanë se përmirësimi i gjendjes shëndetësore do të bëhet me kalimin e kohës. Gjatë qëndrimit tim në klinikën e Sionit, dhembjet e mia nuk kishin pushim, për çka edhe u kërkoja ndihmë infermiereve dhe mjekëve për të më marrë parasysh dhembjet e padurueshme... Por ata, në vend që të kujdeseshin sipas profesionit të tyre human, më provokonin duke më nxituar që, me fajin tim, të lëshoja klinikën dhe të mbetesh në mëshirën e dhimbjeve. Dhe më në fund, ata më norxën nga klinika pa më dhënë kurrfarë përmirësimi të gjendjes sime shëndetësore. Pas 4 ditësh nga dalja nga klinika, në banesën time më vazhduan dhembjet e padurueshme duke u rritur me krizë edhe më të madhe, duke u përhapur në krahun e majtë dhe në shpatull, nën sqetull, në anën e majtë të fytyrës si dhe në anën e majtë të boshtit kurrizor duke shkruar deri në tru. Pastaj mu keqësua edhe frymarrja. Mu skuqën veshi i majtë, qafa në anën e majtë, si dhe të gjitha pjesët e trupit nga ana e majtë gjithashtu. Familja ime, e shqetësuar nga kjo gjendje shumë delikate e shëndetit tim, thirrri ndihmë e shpejtë... Aty, duke më parë të tillë, më dhanë ushqim artificial-infuzion dhe pastaj Morphine. Neurologu deklaroi se është i panjohtuar për këto simptome dhe kërkoi ndihmë e shefit neurologjik për sëmundjen algoneurodystrophie. Pas shumë orvë pritje, më në fund arriti neurologu, i cili pas ekzaminimit, konsatton se gjendja ime ishte tejet e komplikuar dhe nuk ka mundësi të më ndihmojë. Ai më sygjeroi që të shkoj në banesë duke më premtuar se, në konsultim me kolegët e vet, do të bëj të mundshme një egzaminim më të përsosur. Por kjo nuk ndodhi dhe as që ka ndodhur deri më sot.

Fillimisht dyshova derisa u binda plotësisht se të gjitha këto injorime dhe keqtrajtime medicinale kanë qenë të ndikuara nga mjekët e Sigurimit Shëndetësor, SUVA. Mjekët e dinin mirë shkakun e gabimit profesional mjekësor dhe detyrimisht edhe dëmin moral dhe material që më detyrohen ligjërisht. Por bashkëpunimi i tyre jo në favor të shëndetit tim por te rrënimin të mëtejshëm të tij tregon se asnjëri prej tyre nuk dëshironte shërimit tim. Madje ata janë të interesuar që të më paraqesin edhe si të sëmurë psikik, mjaft që të mbulonin fajin e tyre duke e pasur nesër më të lehtë para gjykatës pasi fjalët e një të sëmurë psikik nuk merren në konsideratë. Por unë posedoj deklarata të hartuar nga mjekët të tjerë të cilët vërtetojnë pretendimin tim, pra atë se ndaj meje është bërë një ndërhyrje e pafalshme kirurgjikale e cila më ka lënë pasojat të pariparueshme.

A jeni vizituar jashtë Zvicrës?

Duke mos humbur shpresat për një trajtim human e mjekësor dhe duke hulumtuar edhe nëpërmjet internetit, vendosa që të shkoj për një kontrollim rutinor në një poliklinikë e specializuar për durar – d.m.th. te një specialist i njohur në Belgjikë, konkretisht te Dr. Huard në klinikën "Parc service electromyographie". Kjo u realizua më 26 gusht 2005. Pasi kontaktova, me anë të telefonit, mjeku belg më caktoj një takimim të shpejtë, për çka edhe i jam shumë mirënjohës. Ai më dëgjonte me shumë vëmendje për të gjitha peripeçitë e mia dhe pas shikimit të dokumenteve mjekësore që ia tregova si dhe pas kontrollimit shumë të kujdesshëm më pyeti i habitur: "Kush është ai mjek që të ka thënë se duhet t'i nënshtrohesh një operacionit të tillë?".

Dhe pasi më sqaroi se "ky hap i mjekëve



zviceran ishte shumë i gabuar, dhe si pasojë, sëmurja jote nuk vjen vetëm nga "algoneurodystrophie", por nga ky operim i gabuar duke të dhënë se gabimisht anestazonin post-opëroire, dhe diagnoza e saktë quhet "plexus brachial". Në vend që të përdornin likidin për të pirë dorën ata përdorin një likid që quhet Klorur Postazium Toksik. Kështu tu dëmtuan 10 nerva. Por nëse ky gabim do të bëhej me gjilpërë nuk do të ishin lënduar më shumë se një apo 2 nerva e jo tërë zona e plexus brachial. Vetum një toksike mund ta bënte një lëndim të tërë.", konfirmoi mjeku belg Huard. Këtë e dëshmojnë më së miri EMG dhe 2 fotografi mjekësore, përkatësisht njëra e bërë në Bruksel e tjetra në Kosovë. Njëkosisht kjo vërtetohet edhe nga një ekspertizë juridike e pavarur që kemi bërë në Gjenevë etj. Kjo është një sëmundje e përjetshme dhe e pashërueshme sipas të gjithë mjekëve që më kanë vizituar më pas. Këtë diagnozë e vërtetojnë të gjithë vizitat që bëra pas atij operacioni fatal në klinikën "La Source". Nga nevoja për një shërim adekuat kam shkruar të shumë specialistë, si në Kosovë, Austri e Gjermani gjithë ashtu në France, ku më kanë thënë se diagnostifikimi i mjekut nga Belgjika është i saktë, kuptohet edhe pas një egzaminimit të tyre. Me fjalë të tjera janë tërë nervat e mia të lënduara ne territorin plexus brachial, dhe gjithashtu një infektim.

Këtë gabim të pafalshëm gjatë operimit tim si dhe kushtet në të cilat unë u operova pa praninë e mjekut anesteziest e ka konstatuar dhe dokumentuar edhe Dr. Anne-Marie Bendahan në Strasbourg e cila është në të njëjtën kohë edhe Sekretare e Shoqatës Kombëtare të Mjekëve të Këshillit të Rekursit në Francë. Zonja Bendahan u prek dhe në të njëjtën kohë u revoltua shumë kur pas vizitës që më bëri mësoi gafat e pafalshme profesionale të Dr. Stuzeneggerit. Deklaratat e lëshuara prej saj ju i keni në dispozicion. Kjo zonjë e ndëruar më është shprehur e gatshme që të dëshmojë profesionalisht para cdo gjykate, si në Zvicër ashtu edhe në Gjykatën Europiane në Strasbourg për çështjet që kam hapur kundër mjekëve "La Source" dhe Dr. Stuzenegger që më shkatërruan jetën. Po kështu edhe mjaft mjekët të tjerë belgë, austriakë, kosovarë dhe madje edhe zviceranë, pasi më kanë vizituar janë në të njëjtën linjë profesionale dhe janë edhe ata të gatshëm që të dëshmojnë...

Nga të gjitha këto që u thanë më lartë jeta ime është shkatërruar. Kjo vjen nga injorimi, mungesa e humanizmit dhe e vullnetit të mirë nga ana e disa mjekëve në Zvicër si Dr. Stuzenegger dhe ekipi i tij. Edhe më pas ky i fundit u tregua mjaft arrogant. Unë habitem se si monstra të tilla kanë bërë Betimin e Hipokratit. Ata preferojnë që të mbeten solidarë në paafësinë dhe pandershmërinë e tyre në vend që të tregojnë të vërtetën dhe të bëjnë përpjekje për të më shëruar atëherë kur kjo mundësi ekzistonte. Përballë kësaj padrejtësie unë gjendem i dënuar që të mbetem hendikap përjetë. Është kjo arsyeja për të cilën ngjarja ime nuk ka obliguar që t'ju lutem juve për ta publikuar në mënyrë që padrejtësi të tilla të mos të përsëritet më kurrë.

Gjatë bisedës jeni shprehur për presionet, incidentet e deri në atentatet fizike që janë kryer ndaj jush dhe pjestarëve të familjes suaj me qëllim që t'ju detyrojnë që të heshtni për këtë skandal. Lutem të ndaleni konkretisht në rastet që ka qenë më të rëndë dhe flagrant.

Po, është e vërtetë. Një atentat i rëndë më ka ndodhur në korrik të vitit 2006 kur isha në Kosovë. Po pija një kafe me një mik timin në një lokal të Prishtinës dhe shoh të na afrohet një person që fliste frëngjisht dhe që po tentonte të më fotografonte. I thashë që të largohet se nuk doja që të fotografohesha nga një i panjohur por ai vijonte të më shikonte dhe kjo më bëri të dyshoj. Pas pak minutash hipëm në makinë dhe duke u kthyer jashtë Prishtinës, në afërsi të një tuneli, një person na kishte dalë para në anën e majtë, ne mesin e hyrjes së tunelit. Ai shkrep një plumb me snajper në drejtimin tim. Shpëtova për mrekulli sepse kisha ngadalësuar instiktivisht paksa shpejtësinë kur pashë këtë skenë



dhe pashë flakërimin e plumbit pak metra para automjetit. Atë ditë më ka shpëtuar Zoti. Qysh atë ditë e kuptova përfundimisht se duan të më eliminojnë fizikisht në pamundësi për të më mbyllur gojën për të drejtat e mia lejitime të përdhunuara në mënyrë flagrante nga shteti zviceran. Miku im ishte prezent dhe mund të dëshmojë për këtë atentat që për pak më kushtoi jetën. Gruaja u trondit shumë dhe gjatë një kontrolli të imët që i bëri automjetit tonë për siguri, gjeti një aparat të vogël përgjues. Vëllai e ruajti këtë për të bërë denoncimin dhe për momentin më largoi larg nga shtëpia për arsye sigurie.

het... Kur u ktheva në shtëpi përjetova një tronditje akoma edhe më të madhe. Gruaja ishte zverdhur dhe shokuar nga incidenti pasi kishte parë cdo gjë në momentin kur doli nga shtëpia. Në këto kushte depresive ajo humbi fëmijën tim të dytë sepse ishte shtatzënë... Vetëm pas pak kohësh mësova nga burime të mirëinformuara se lituanezi që kapëm dhe denoncua kishte dy të afërëm nga rrethi i tij familjar që punonin në klinikën La Source. Pra dyshimet dhe akuzat që bëra bashkë me vëllain qenë të bazuara dhe të sakta sepse unë nuk kisha të bëja me atë njeri. Në këto kushte e denoncova edhe këtë fakt por përgjigja

bela i shkroi një letër prej 2 faqesh Këshillit Federal të Zvicrës duke i përmblendhur kalvarin e vujatjeve të mia dhe të familjes. "Stop eksperimenteve humane", "...C'farë do të bënit ju po të ishit në vendin tonë?", janë disa nga pyetjet që ajo i drejtohet këtij institucioni.... Për pak kohë na lanë të qetë por provokimet nga më vulgaret edhe nga ana e policisë dhe civilëve të veshur me pushtet vijuan edhe më vonë... Në këto kushte flagrante diskriminimi dhe represioni ju iu drejtuar gjykatës dhe prokurorisë. C'farë padish dhe kundër kujt i keni ngritur konkretisht?

një klinike private apo shtetërore (!!). Ky fakt ndodhet në fq 11 të dokumentit konfidencial që ju kam vënë në dispozicion. E gjeni në fq. 11. Por atë nuk e detyroi askush që ta merrte rastin tim. Ndërkohë me avokatit e tretë fillova procedurën penale dhe civile por edhe ky u tërhoq pas presioneve që i erdhën nga funksionarë të kantonit të Vaudit pasi kishte përfutuar edhe ky mjaft pagesa për shërbimin e tij të pakryer ndaj meje. Në rastin më të mirë avokatët zviceranë i shoh të pafuqishëm për çështjen time. Ky është realiteti në Zvicër. A keni ende shprese te drejtësia per shkel-

kantoni i Vaudit, gjykata e të cilit ma bllokoi dhe sabotoi çështjen time deri duke tentuar që të më zhdukte dosjen. Ka ndërhyrë me një letër pranë Ambasadës së Zvicrës në Prishtinë për problemin tim edhe Ministri i Jashtëm i Kosovës Enver Hoxhaj. Këtë letër e kam dorëzuar unë së bashku me Këshilltarin e z. Hoxhaj. Asnjë përgjigje. Së fundi i kam shkruar për dramën që po pë rjetoj në shkurt të këtij viti edhe Ministrin të Jashtëm të Zvicrës. Përsëri heshtje... Në rast se çështja ime do të vazhdojë të zvarritet atëherë unë do të dal publikisht së



Jam sulmur edhe pranë banesës sime natën e 22 shkurtit 2009 nga 5 persona të maskuar dhe të armatosur. Dhe ky atentat erdhi gjatë periudhës kur unë komunikoja me gazetarin Fabio Bonavita të "Lausanne Cites" në lidhje operacionin e gabuar gjatë operimit tim në klinikën "Source". Me fjalë të tjera unë kam qenë dhe me siguri që vijoj të jem i survejuar në lëvizjet e mia. Po kthehesha në shtëpi dhe pashë 5 persona në 2 automjete. Ata kishin parkuar njërin makinë në vendparkimin tim dhe tjetrën në anë të rrugës. Kur e pashë këtë skenë nga makina ime kam tentuar që të kthehem me shpejtësi nga rruga kryesore, bërtita dhe i telefonova vëllait tim që banon aty pranë. Gruaja ime që ndodhej në shtëpi dëgjoji thirrjet e mia dhe doli të dera. 4 prej tyre u larguan menjëherë sepse më panë kur telefonova nga makina. Njëri prej tyre deshi të më qëllonte por në atë moment kaloi një makinë dhe dritat e dejuara nga ne e frikësuan agresorin duke kujtuar se mbase ishte policia. Kjo rastësi më shpëtoi. Ndërkohë unë arrita që të bllokoja njërin prej tyre me ndihmën edhe të vëllait që mbërriti menjëherë. E mbërthyem në flagrancë sepse nuk kishte mundësi si manovrimi në një rrugicë qorre dhe i morëm kartën e identitetit për ta denoncuar në polici, së bashku me një foto që ia bëmë po aty me celular. Ishte nga Lituania. Në stacionin e policisë në Renens na pyetën se nga kush dyshonim se më vjen ky agresion. Ia bëmë të qartë se qysh nga dita e operimit tim fatal, shumë incidente kanë ndodhur me mua dhe për këtë bëj fajtor punonjësit e paguar të SUVA dhe klinikën "La Source". Policët u treguan indiferentë duke më thënë se kjo akuzë nuk ka se si provo-

ishite mëse qesharake; Sipas policisë lituanezi që bënte pjesë në grupin që më sulmuan para shtëpisë nuk jetonte më në Zvicër (!!!). Në fakt kam informacione të sakta se ai jeton edhe sot në zvicren gjermane. U demoralizova edhe më tepër pasi mësova se tashmë aleatë me bluzat e bardha të klinikës Source dhe SUVA-s ishte bërë edhe policia. Pajtuam një dedektiv privat dhe ai arriti që të mbërthente dhe të shtrëngonte mercenarin ordiner nga Lituania që të pohonte të vërtetën në lidhje me agresionin kundër r meje. Po kë shtu, një dedektiv privat që pajtuam me pagesë na bëri të ditur se lituanezi kishte lidhje me klinikën "La Source" pak kohë pas denoncimit që i bëra për r agresionin e tij të provuar. Bashkangjitur keni deklaruar e lituanezit ku ai pohon se është paguar me 5 mijë franga zvicerane për të hyrë në shtëpinë time dhe për të zhdukur cdo dokument kompromentues të dosjes sime. Përse do të ishte i interesuar për zdukjen dosjen time litonezi i panjohur dhe mbase ende pa dokumenta të rregullta në Zvicër? Pra ka qenë klinika "La Source" që e ka ushtur nga pas për të mos dalë vetë në skenë. Gjykata e Kantonit të Vaudit vendosi pushimin e çështjes për mungesë provash sepse askujt nuk i interesonte e vë rta. Fillova të dyshoja sepse Kantonit i Vaudit duke mose dëshiruar një imazhe të keqe para bote dhe një skandal të tërë dëshiruan përsëri heshtje (!) megjithëse ne e denoncua në flagrancë agresorin pasi e detyruam që të na jepte identitetin. Ju përmenda vetëm 2 nga sulmet dhe atentatet më të rënda që kanë organizuar kundër meje por ka edhe të tjerë gjatë këtyre viteve... Pak muaj pas këtij sulmi, gruaja ime Isa-

Unë kam hapur gjyq kundër SUVA (Sigurimi Shëndetësor i Aksidentëve në Punë), kundër kirurgut Michael Stuzenger, kundër Klinikës "La Source" si dhe kundër infermiere Sabine Noel e cila u fut në mënyrë jologjore në sallën e operacionit duke zëvendësuar mjekun anestetizist si shkakuar të përkëqsim-it të mëtejshëm të gjëndjes sime shëndetësore. Për mua ka një çështje sociale për pensionin prej 9 vjetësh, një procedurë penale që prej 3 vjetësh dhe një procedurë civile. Në të trija rastet ka vetëm zvarritje të qëllimshme për të mos ardhur në vendimin i cili dukshëm që është në favorin tim. Të gjithë këshilltarët e shtetit në Ministrinë e Shëndetësisë janë të mirëinformuar me dosjen dhe vujatjet e mia por ata preferojnë që të heshtin. Vetëm para pak kohësh më kanë zhdukur një pjesë të rëndësishme të dosjes sime civile në Gjykatën e Kantonit të Vaudit duke arritur që t'i thonë me pafytyrësinë më të madhe gruas sime se dosja ime nuk ka ekzistuar kurrë. Por unë posedoj të gjithë dokumentet origjinale duke qenë i vetëdijshëm më përpara për këto manovra të ulëta nga ana e tyre.

jet që ju janë bërë? Si do të operoni konkretisht ndaj këtyre padrejtësive që ju kanë bërë dhe që t'iu vuan ende? Unë shpresoj gjithmonë se drejtësia do të fitojë por jo në Zvicër. Tani çështja ime ndodhet në Gjykatën Europiane të Strasburgut për zvarritje që Gjykata e Kantonit të Vaudit i ka bërë qëllimisht çështjes sime. Unë do ta vazhdoj luftën time deri në fund në bazë të dosjes së plotë të provave të pakontestueshme që i kam paraqitur atje. Dua t'i tregoj kë saj Gjykate të nderuar dhe Këshillit të Europës se Kosova u kritikua ashpër për r zvarritje të çështjeve gjyqësore deri në 5 vjet në një kohë që çështja ime po zvarritet prej 9 vjetësh në një shtet si Zvicra. Gjykata e Kantonit të Vaudit, jo vetëm që nuk ka marrë asnjë vendim për denoncimet e mia flagrante por për r kundrazit ka tentuar që të më demoralizojë dhe demotivojë duke i zvarritur çështjet. Në këtë mënyrë ata kanë kalkulluar sik duket se e vetmja mënyrë që çështja Querimi të sabotohet për në Gjykatë e Strasburgut është bllokimi i procedurës qysh në Gjykatën e Kantonit. Pra një shkallë më poshtë se Gjykata Federale e shtetit helvetik e cila as që e njih ende dosjen në fjalë. Sepse bluzat e bardha, policia dhe togat e zeza të kantonit të Vaudit janë të implikuara në këtë aferë. Ata kanë prerë hallkë në e ankimit tim duke ia fshehur këtë edhe pushtetit federal të Zvicrës. Unë i bëj apel Federatës së Zvicrës që të reagojë ligjërisht ndaj këtyre presioneve që po vijojnë të më bëhen mua dhe familjes sime, vetëm e vetëm se po ngrë zërin për të drejtat e mia të mohuara. Kjo sepse në rast se Gjykata Federale do të merrej seriozisht me këtë çështje, të gjithë fajet do t'i merrte

bashku me familjen në një grevë të pakthyeshme urie përpara një prej institucioneve kryesore të shtetit zviceran. Le të shërbejë vetësakrifikimi im me qëllim që kjo fatkeqësi që më ndodhi mua të mos u ndodhë emigrantëve të tjerë në Zvicër. Durimi im ka marrë fund dhe kjo që ju thashë do të ndodhë shumë shpejt nëse autoritetet përgjegjëse në këtë vend do të bëjnë të paditurin. Në një shtet demokratik është detyrë parësore mbrojtja e shëndetit dhe e jetës së shtetasve të tij. Në mbyllje a keni ndonjë mesazh për të dhënë? I lutem publikisht Kryeministrin të Kosovës dhe qeverisë së Shqipërisë që ta ngrënë zërin me shumë për të drejtat e mohuara të shqiptarëve në mërgim duke caktuar me ligj për këtë temë një hapësirë të caktuar në televizionet respektive shtetërore. Por në vccantit, lutja ime shkon për Kryeministrin e Shqipërisë që të më ndihmojë duke ushtruar autoritetin e tij shtetëror dhe politik për këto që po heq prej 10 vjetësh në Zvicër me qëllim që drejtësia të vihet në vend. Për mua e rëndësishme është që të ndërhyjë autoriteti I shtetit shqiptar e jo cili individ që është në krye të tij sepse këtë të fundit e vendos sovranin me votë. Zëri i shtetit shqiptar ka më shumë peshë në arenën ndërkombëtare në krahasim me Kosovën sepse Shqipëria sapo mbushi 100-vjet shtetformim dhe është vend anëtar i NATO-s. Familja ime, djali im 8-vjeçar kanë plotësisht të drejtë që të jetojnë në paqe dhe në harmoni si dhe me dinjitet pas afro 10 viteve frike, ankthi dhe pasigurie për të nesërmen.

Nostalgjia për Enver Hoxhën

Nga **Ardian Ndreca**
Ambasador në Vatikan

Tregon Svetoni, historian romak i shekullit II, sesi mbas vdekjes së Neronit nuk munguen ata që për vite rresht ia zbkuronin vorrin me lule dhe afishonin në vendet e caktueme publike shembelltyrat e tija dhe kopjet e dekreteve sikur të ishte ende gjallë.

Gjithë koha ndërmjet nesh dhe Neronit asht e mbushun me devocione dhe nostalgji të çmendunish për individë që botnisht dihet se i kanë shkaktue njerzimit kryesisht vuetje dhe mundime. Ende sot ka nostalgjikë të Hitlerit, Stalinit, Pol Potit, Idi Amin-it... Enver Hoxhës e shumë të tjerëve që kanë qenë mjaft larg qenjes "njerëz mes njerëzve".

Fenomeni i nostalgjisë vërehet edhe tek ne, pothuajse në çdo përvjetor të vdekjes së diktatorit Enver Hoxha. Nuk ka asgja për t'u çuditë nëse mbasardhësit e tij biologjikë e mbrojnë, pse ata janë ndër të paktit që nuk e kanë pasë frikë qenjen e tij sa ishte gjallë, nga ana tjetër nuk përban tashma një domosdoshmëni për ta, pasja e një ndjenje morale që t'i bante me ndie sadopak keqardhje për viktimat e pafajshme e të kota që ka shkaktue prindi i tyne.

Ajo që ban përshtypje asht gatishmënia e publikut dhe e disa mediave me ndie përrallat e sheqerosuna të bashkëshortes dhe fëmijëve të diktatorit Hoxha.

Përgjatë shekullit të kaluem Enver Hoxha ka qenë udhëheqësi ma i pakuptimtë në Europë, qenja dhe veprimi i tij politik, thjesht, kanë damtue vetëm popullin e tij, pa i sigurue – siç e tregoi vetë koha – asnjë të ardhme tjetër, që të mos ishte mizerja materiale dhe morale.

Izolimi i tij ekstrem e bante të pakuptimtë dhe të padamshëm politikisht për botën perëndimore, të bezdisshëm por të tolerueshëm për fqinjët, të damshëm deri në vdekje për të vetët.

Dhuna që ai dhe sistemi i tij ushtroi në kohë paqet ndaj një populli të tanë ishte krejtisht e pajustificueshme, të mirat e pandehuna që paska prodhue ajo dhunë janë të pavërtetueshme historikisht.

Sa për rolin e tij gjatë Luftës së Dytë mund të themi se qëllimi i tij, jo i të gjithë atyne që luftuen përkrah tij, ishte marrja e pushtetit. Këtë gjë e treguen mungesa e skrupujve, oportunizmi i skajshëm, vrasjet pa kriter të shokëve të tij komuniste, gjatë dhe sidomos mbas konfliktit botnor. Do të ishte shumë naive po të mendonim se roli i Enver Hoxhës në rikthimin e sovranitetit të Shqipnisë ka qenë vendimtar. Fatet e Luftës së Dytë botnore vendoseshin dikund tjetër dhe jo në shkrepat apo në rrugët mesjetare të Shqipnisë.

A do të vijonin, po të mos kishte qenë Enver Hoxha me gueriljet e tija, trupat gjermane me ndejt në vendin tonë mbas kapitullimit pa kushte të Gjermanisë naziste? Vetëm disa historianë qesharakë mund të pohojnë të kundërtën. Në

qoftë se veprimi i tij ushtarak do të kishte pasë sukses, atëherë mbas çlirimit të Shqipnisë, në Greqi do të duhej të kishte ende trupa gjermane, por jo, Shqipnia u lirue prej gjermanëve në tërheqje dhe nuk u çlirue prej një frikacaku që nuk mori pjesë

me ndihmën e tyne Kanalin e Korfuzit dhe aniqsoi vendin me aleatët. Por nuk u mjaftue me kaq, si njeri pa njohunitë elementare të artit ushtarak, ai spostoit frontin grek të luftës mes monarkistave dhe komunistave në territorin shqiptar, tue u

dit tonë, duke qenë se një konflikt i mundshëm mes superfuqive do të zhvillohej edhe në territorin shqiptar, me pasoja katastrofike për vendin tonë.

Oportunizmi i tij i pashoq politik, nuk e pengoi menjherë mbas

eksperimenteve të pangjashme politike solli një përkeqësim gjithnjë e në rritje të gjendjes ekonomike të shqiptarëve. Izolimi nga rrjedha e zhvillimit të shkencës, arteve dhe kulturës botnore atrofizoi forcat dhe çoi pak nga pak në krijimin e "njeriut të ri socialist", një hibrid i frustruem i terrorit radikal, fryt i injorancës, dhunës dhe fanatizmit ideologjik.

Asht qesharake tentativa me ia mveshë Enver Hoxhës dhe regjimit të tij disa të mira që vetë koha i sjell me vete kudo. Në qoftë se elektrifikimi i vendit do të kishte promovue kultivimin e shpirtit të lirisë dhe jo indoktrinimin dhe rranjosjen e gënjeshtres së ngritun në rang sistemi, atëherë do të kishim folë për një arritje të mirëfilltë. Liria personale nuk asht e zëvendësueshme prej llampës elektrike, ashtu siç nuk asht e zëvendësueshme drita e diellit prej dritës elektrike.

Ka disa të këqija radikale që mbahen gjallë prej disa të mirash të vogla, ashtu siç mbahet gjallë zjarri shkatërrimtar prej pranisë së oksigjenit.

Dekadat e komunizmit e rreshtuen Shqipninë, përta i përket zhvillimit dhe pasunisë së individit, në një linjë me vendet ma të mbrapambetuna afrikane, komunizmi despotik shqiptar nuk ruente asnjë tipar të frymës së komunizmit perëndimor. Çdo e mirë spontane natyrale e shqiptarëve ishte tjetërsue nën vulën e një ideologjie që identifikohej me kultin e një personi të vetëm. Mund të themi se frytet e komunizmit shqiptar, siç ishte propagandue, i gëzonte vetëm një lagje e Tiranës e mbiquejtun "Bllok". Andrra e komunizmit me realizue parizin në tokë ishte vërtetue vetëm për një grup të vogël burokratësh totalisht të paaftë për nevojat e kohës, të pamoralshëm dhe shpeshherë kriminela, pse vetëm ata thithnin simbas standardeve të propagandue nga regjimi frytet e gjithë djersës dhe sakrificave të shqiptarëve. Megjithatë, tue qenë se Shqipnia nuk ishte një shtet i së drejtës por një sulltanat arbitrar, as ata nuk ishin të sigurtë. Kjo ishte gjendja katastrofike e fundit të viteve '80.

Seria e madhe e bashkëpunëtorëve të Sigurimit, e përfituesve të autorizuem të pasunive të vendit, e oportunistave të pamoralshëm që u aktivizuen në politikë mbas vitit 1990, i siguroi udhëheqjes komuniste një tranzicion të gjatë e të parrezikshëm që zgjati ma se 20 vjet. Asht paradoksal fakti, por tranzicioni nga "mesjeta" otomane, në vitin 1912, deri në themelimin e Shtetit shqiptar, 1920, ka qenë ma pak problematik se ai nga komunizmi "alla enver hoxhë" në një shoqni liberale që ende na mungon. Fakti që sot ka prej atyne që guxojnë me rehabilitue Enver Hoxhën, mvaret edhe prej zhgënjimit që sollën me vete pinjojtë e tij që drejtuen tranzicionin ma poshtnues të historisë së kombit shqiptar.



në asnjë betejë.

Edhe mbas luftës Enver Hoxha nuk bani asgja për riejtjen e sovranitetit të vendit. Dy territoret shqiptare që duhet të diskutoheshin në mbarim të luftës ishin Kosova dhe Çamëria, por nuk ka asnjë dokument historik që të vërtetojë impenjimin e Hoxhës në këtë drejtim ose të paktën, të paktën, në ngritjen e zanit në favor të të drejtave elementare të shqiptarëve të atyne viseve.

Ndërkaq ai ua dorëzoi jugosllavëve ekonominë kombtare, minoi

ba shkak i ofensivës greke që shkaktoi viktimat të shumta ushtarake dhe civile ndër ne. Pra, në një linjë me qeverinë fashiste të vitit 1940, Enver Hoxha provokonte 9 vite ma vonë Greqinë tue lejue sulmet komuniste greke prej territorit shqiptar dhe tue rrezikue randë sovranitetin e vendit.

Ma vonë, vendosja e një baze sovjetike në Vlorë e shndërroi Shqipninë në një karakoll sovjetik në Mesdhe, tue rrezikue, në klimën e Luftës së Ftohtë, sigurinë e ven-

prishjes me sovjetikët me deklarue se mbështeste ushtarakisht Jugosllavinë dhe pranonte mbështetjen jugosllave në rast agresioni nga ana e kampit socialist.

Planet e tija të pandehuna me sulmue Jugosllavinë në fillimet e viteve '80 mund t'i besojnë vetëm ata që kanë një ide të forcave ushtarake të dy vendeve, të ngjashme me idenë që mund të kenë për luftat asiro-babiloneze.

Shkatërrimi i ekonomisë kombtare si pasojë e izolimit dhe e

Avokati Spartak Ngjela: S'kanë nga ikin hajdutët e politikës! Ndërkombëtarët kanë zbuluar dhuratat dhe darkat e të korruptuarve shqiptarë

Avokati Spartak Ngjela, i cili njëherazi drejton edhe Partinë Ligj dhe Drejtësi, deklaroi ditën e djeshme se ndërkombëtarët kanë arritur të zbulojnë çdo të fshehtë për pushtetarët e korrumpuar shqiptarë.

Gjatë një prononcimi për gazetën "SOT", Ngjela u shpreh se në kuadër të reformës në drejtësi dhe kontributit që po jepet nga ndërkombëtarët, këta të fundit kanë arritur të identifikojnë pasuritë e paligjshme, ryshfetet dhe darkat e dhuratat që kanë marrë.

"Janë katër të korrumpuar të mëdhenj, të cilëve ekspertiza perëndimore iu ka identifikuar jo vetëm pronat e paligjshme që kanë marrë si pushtetarë, jo vetëm paratë, por dinë edhe shpenzimet që kanë bërë nëpër hotele, për darkat që kanë ngrënë, për dhuratat që kanë bërë dhe për të gjitha ryshfetet që kanë paguar në funksion të shitjes së interesit kombëtar", theksoi ai.

Sipas Ngjelës, në Shqipëri ekzistojnë katër politikanë të korrumpuar të cilët po tentojnë të gjejnë shpëtim nga drejtësia duke u orientuar tek Rusia. Mirëpo më tej, avokati shtoi se tentivat e tyre janë të kota sepse së shpejti

për qytetarët shqiptarë do të triumfojë drejtësia. "Janë të shqetësuar mendërisht dhe gjithë shpresa e korrupsionit shqiptar të përqendruar tek katërshja: Berisha, Rama, Meta dhe Basha është nisur që të krijojë një rrymë të re mbrojtëse politike për t'i shpëtuar ndëshkimit nga korrupsioni. Shqiptarët shumë shpejt do të tallen me ata sepse ata nuk kanë më asnjë lloj force për të shpërngulur drejtimin politik nga Perëndimi në Lindje", nënvizoi Spartak Ngjela.

Ndërkohë, kujtojmë që pak ditë më parë avokati përsëriti deklaratën e tij se së shpejti të gjithë të korrumpuar shqiptarë do të bien në rrjetën e drejtësisë. "Në fakt reformës në drejtësi nuk do i shpëtojnë dot sepse ligjet që vetë kanë miratuar nën forcën e politikës amerikane, po me këtë forcë do t'i zbatojnë domosdoshmërisht. Tani kuptohet që ka ardhur bash koha që vetë krerët e korrupsionit shqiptar duhet të dorëzohen një nga një. Kuptohet që Rama ka ende shpresë se ky dhe Saliu mund të shkatërrojnë Shqipërinë për të shpëtuar nga ndëshkimi penal", tha Spartak Ngjela.



The Albanian mafia in Kosovo attempts to develop mass production of genetically modified cocaine

Saviano said in an interview that the Albanian mafia in Kosovo chiefs “dream” about turning the province into “a European Colombia”. “In order to achieve this, they wish to genetically engineer a type of coca plant that would grow in Kosovo’s climate.

In this way, the Albanian mafia would have a monopoly over the cocaine trade. They need 20 years to achieve this,” he said, and added that “then, Kosovo will without a doubt become the new Colombia”. Saviano has spent the past three years living under round-the-clock police protection, with the crime families sending out messages that he would be punished for writing the book, which he based on his own investigations.

Roberto Saviano (Gomorra) returns with a blistering, no-holds-barred account of the international cocaine trade entitled, *Zero Zero Zero*.

Berliner Zeitung daily stated that Kosovo is poor and overpopulated, and despite its flag and anthem, will not become an equal European nation like Denmark or Bulgaria. What’s more, the article published on Monday says, nobody has pretensions of that nature. When Kosovo politicians try to go against something their tutors have said, which they dare do from time to time, they know in advance that nothing will come of it, the daily continued.

It adds that in the best case scenario, in ten years, Kosovo will become a European province with local government, but all decisions will be made by Brussels.

Austrian Vorarlberger Nachrichten writes that Kosovo depends on foreign help now more than ever and that



the struggling economy is still waiting for foreign investments.

“Even though billions have been pumped into Kosovo, there are few shining examples. Several kilometers of highway towards Albania and the largest city to the west, Peć, have been finished. If there is any internal political progress, it is very slow,” the daily writes.

Vienna newspaper Presse says that the international organizations in

Kosovo are “stepping on their own toes”-the international officials, EULEX, the old UNMIK which wants to leave the province, but can’t, and the OSCE in between.

The daily states that the economic situation is difficult and is getting worse because of the global crisis.

“The number of countries that recognized Kosovo is small,” Albert Rohan, a former deputy UN envoy in the Kosovo status negotiations, told the

daily.

“That is a sign that the influence of the U.S. is decreasing,” he said, adding that the lack of unity within the EU is also “responsible” for this.

All this provides typical environment for narco cartels and their business, as (surprise!) UN stressed in one of their reports, titled UN: Kosovo heart of Balkan drug route.

TNT EXPLOSION IN SHKODRA, WITHOUT CASUALTIES

The midnight of two days ago, exactly at 23:30 minutes on 6 May, 200 gram of TNT broke out in the house where Indrit Puka was sleeping in the “Ahmet Haxhija” neighborhood of the city of Shkodra. The explosive substance was thrown into the backyard by unidentified persons, where there were no injuries. According to

early information, the author of this outbreak has been a member of the Pirani family, a tribe known by the police, but who have consistently managed to commit crimes and escape the justice, thanks to the connections with politicians who illegally collect votes during the campaign time. There are a few days since Indrit Puka has returned from the French state, where he has sought asylum for property conflicts with the Pirani family. These two tribes had strong property conflicts since 2009.

The Puka family had been locked in for a long time from the fear of murder. In life-threatening conditions,



they had been relocated to France with all one’s family, but recently one of the sons of this family, Indrit Puka, returned from the French state and as soon as he came, they stood ready with the attack.

In fact, even two years ago, the mafia family Pirani has shot fire in the neighborhood where Indrit Puka lives, so in the “Ahmet Haxhija” neighborhood, the citizen Mir Alija got killed. The latest event has shocked the neighborhood residents, because the explosion has been powerful.

The Editorial Office

Vatikan: Zbulohet dokumenti ku Gjergj Kastrioti është shpallur mbret

Nga: Violeta Murati

Vatikani zbulon një deshmi sekrete të historisë shqiptare. Për herë të parë del në dritë dokumenti ku është shpallur Skenderbeu mbret. Një akt diplomatik, mandat, në të cilin emërohet Martin Muzaka ambasador i Skenderbeut. është një letër origjinale në pergamen me një vulë shtetërore të varur, që ruhet në Arkivin Sekret të Vatikanit në fondin; Miscellanease, vëllimi XXXIX, dokumenti 2398, nga viti 1458. Pikerisht në këtë mandat Skenderbeu quhet "mbret". Ka qenë dr. Musa Ahmeti një hulumtues i ka kohshëm i arkivave të Vatikanit që ka publikuar disa ditë më parë, në internet, mandatin e mbreterisë shqiptare.

Si u gjet vula e mbretit

Hulumtimet nëpër arkiva e biblioteka të ndryshme, kanë mundësuar zbulime të reja të ketyre akteve, për të cilat më parë është menduar se janë zhdukur apo nuk kanë ekzistuar fare. Duke u nisur nga këto hulumtime, të kohëve të fundit (viti 2000)], studiuesi nga Zagrebi, Ahmeti, në Arkivin Sekret të Vatikanit në Vatikan, në fondin: Miscellaneae, nga viti 1458, zbulon një mandat (akt diplomatik) origjinal të Skenderbeut, me të cilin emërohet Martin Muzaka si përfaqësues i tij "legjimit dhe legal".

"Dokumenti është i shkruar në pergamen. është ruajtur mjaft mirë", pohon Ahmeti. Dokumenti ka dimensione: 68 x 92.5 cm. Në të janë varura edhe dy vula origjinale. E para vula shtetërore e Skenderbeut dhe e dyta ajo e notarit Johannes Borcius de Grillis. "Në na është bërë e njohur edhe një kopje e këtij mandati që ruhet po ashtu në Arkivin Sekret të Vatikanit, në Vatikan në Fondin: Diversa Cameralia, vëll. 30, f. 134r-v. Kjo kopje është e sakte dhe tepër besnike, pa asnjë leshim nga ana e pershkruesit", pohon studiuesi Ahmeti.

Kur u bë Skenderbeu mbret?

Ishte zgjedhur Rodoni, në jug të Shqipërisë, për të nënshkruar mandatin e mbretit. Sic shenohet nga origjinali, mandati është leshuar më 28 tetor të vitit 1458. I drejtohet papës Piu i II-te, i cili kishte më pak se dy muaj që kishte filluar pontifikatin e tij (Piu i II-te fillon pontifikatin më 3 shtator të vitit 1458 dhe vdes më 15 gusht 1464). "Papa Piu njihej si luftëtar

Dokumenti është i shkruar në pergamen. është ruajtur mjaft mirë", pohon Ahmeti. Dokumenti ka dimensione: 68 x 92.5 cm. Në të janë varura edhe dy vula origjinale. E para vula shtetërore e Skenderbeut dhe e dyta ajo e notarit Johannes Borcius de Grillis. "Në na është bërë e njohur edhe një kopje e këtij mandati që ruhet po ashtu në Arkivin Sekret të Vatikanit, në Vatikan në Fondin: Diversa Cameralia, vëll. 30, f. 134r-v. Kjo kopje është e sakte dhe tepër besnike, pa asnjë leshim nga ana e pershkruesit", pohon studiuesi Ahmeti.

i rrepte për mbrojtjen e fese së krishtere edhe sa ishte kardinal", shkruan studiuesi Ahmeti. Një moment tjetër i rëndësishëm që



terheq vëmendjen të ky mandat është edhe pohimi i notarit publik Johannes Borcius de Grillis se ai "me urdher dhe autorizim të mbretit..." dmth. Skenderbeun e quan Mbret. "Ky moment është tepër domethenës ngase edhe në vulën shtetërore të varur që e shoqëron këtë dokument e gjejmë të shkruar tekstin: Sigil (um) o Regni(ae) o Macedonia(e)o et oAlbania(e) që në gjuhën shqipe do të ishte: Vula e Mbreterisë së Shqipërisë dhe Maqedonisë".

Skenderbeu trashëgon zyren nga i ati, Gjoni

Nga dokumentat mendohet që zyra kancelarike që ishte pranë Skenderbeut të ishte vazhdimësi e të njëjtes zyre, e cila funksiononte të i ati GjonKastrioti. Sipas Ahmetit, flitet që kjo zyre daton në shek XIV dhe fillimi i shek. XV. "Natyrisht që kancelaria e Skenderbeut ishte shumë më moderne dhe ju ishte pershtatur rrethanave dhe kohës kur vepronte. Sipas hulumtimeve të bëra, kemi në dorë një të dhënë tepër interesante, se nga zyra e Skenderbeut, ka ndodhur që mbrenda një dite të nxirren 13 akte të ndryshme diplomatike, të shkruara në 5 gjuhë. Kjo e dhënë tregon se cili ishte komunikimi i Heroit tone kombëtar me shtetet tjera mjeshetare dhe me fqinjët, si dhe roli shumë i rëndësishëm që luante kjo diplomaci ruajtjen e pavaresisë shtetërore dhe territoriale", shpjegon studiuesi Ahmeti.

Historia e kancelarive shqiptare

Gjate mesjetës, sundimtaret dhe princërit shqiptarë kishin zyrat e tyre të kancelarive në nivele të ndryshme si notere, sekretare apo perkthyes. Këto zyra ishin mjaft të zhvilluara dhe mund të renditen në radhën e kancelarive të ngjashme me të njohura, në Evropë, gjë që tregon për nivelin e lartë të zhvillimit dhe kujdesit që tregonin sunduesit shqiptarë në komunikim me sundimtaret tjere. Nga

këto zyra dolën akte, diploma, mandate dhe dokumente nga më të ndryshmet, në disa gjuhë që në atë kohë ishin në përdorim zyrtar. Porse deri më sot ka pak njohuri të mbledhura dhe që ekzistojnë për këto dokumenta origjinale. Pjesa dermuese e tyre sic duket janë zhdukur përgjithmërisht; pjesa tjetër prë të hulumtuesit që ato t'i nxjerrin në dritë dhe t'i botojnë, ndërsa vetëm në këto vite po hyhet në këtë mister deshmish historike ku disa fakte të zbuluara rishtazi. Sipas studiuesit Ahmeti, karakteristike e përgjithshme e ketyre akteve të botuara është se ato nuk ndryshojnë nga ato të sundimtarëve të tjerë, fqinj apo evropianë. Zakonisht në këto kancelari janë përdorur gjuhët kulturore të kohës si: latine, greke, sllave, italiane osmane dhe ndonjë tjetër. Ndërsa ende nuk ka asnjë dokument që është shkruar në gjuhën shqipe nga aktet noteriale.

Hidhet poshtë datimi i studiuesve shqiptarë

Përmbysët një nga datimet e nxjerra nga studiuesit shqiptarë. Me zbulimin e mandati të Skenderbeut nga Arkivat sekrete të Vatikanit, hidhet poshtë data e shkruar deri më tani për këtë dokument. Viti 1963 e vëne nga studiuesit shqiptarë nuk vlen më. Kjo date thuhet se është vendosur pa pasur në dorë dokumentin, as origjinalin dhe kopjen. Ndaj argumentohet gabim ky datim. Me daljen e mandatin të Skenderbeut nga nga Vatikani kjo date kalon rreth pesë vite më përpara, pra në vitin 1458, pra koha kur Gjergj Kastrioti shpallet mbret. Sic verëhet nga origjinali, mandati është leshuar në Rodon të Shqipërisë më 28 tetor të vitit 1458. I drejtohet papës Piu i II-te, i cili kishte më pak se dy muaj që kishte filluar pontifikatin e tij (Piu i II-te fillon pontifikatin më 3 shtator të vitit 1458 dhe vdes më 15 gusht 1464) dhe njihej si luftëtar i rrepte për mbrojtjen e fese së krishtere edhe sa ishte kardinal.

Zbulohet një libër në gjuhën shqipe, më i vjetër se "Meshari"

Behar Gjoka

Janë përsëri ata, austriakët, të dashuruarit e përrjetshëm me shqipen, që këtë radhë na befasojnë me një tjetër zbulim. Bëhet fjalë për një dokument që mund të hedhë dritë për shkrimin më të hershëm të gjuhës shqipe. Profesorët Stefan Schumacher dhe Joachim Matzinger nga Akademia e Shkencave Austriake kanë arritur të zbulojnë një dokument që mendohet t'i përkasë shekullit të XIV, ku shkruhet një shqipe me germa latine.

Studimi ka si qëllim zbulimin e ndikimit të gjuhës shqipe në të gjithë gjuhët e rajonit, por edhe në gjuhët e vdekura. Dy profesorët në studimin e tyre kanë arritur në përfundimin se një pjesë e gjuhëve si latinisht, gjermanisht dhe thuajse pjesa më e madhe e gjuhëve të Ballkanit, kanë elementë të rëndësishëm të gjuhës shqipe. Fakti se një pjesë e foljeve kryesore të shqipes gjenden në këto gjuhë, e vërteton më së miri këtë gjë.

Dy profesorët kanë paraqitur fletën e një libri të Biblës që dokumenton gjuhën shqipe të shkruar në fillim të shekullit të XVI. Nëse do të vërtetohet origjinaliteti i këtij dokumenti, atëherë kemi të bëjmë me një libër më të hershëm se "Meshari" i cili daton në mes të shekullit të XVI. Zbulimi Nuk dihet nëse kemi të bëjmë me një zbulim të mirëfillt shkencor apo jo. Dokumenti që publikohet në web-in zyrtar të Akademisë së Shkencave të Austrisë pretendon se bëhet fjalë për shqipe të shkruar rreth shekullit XIV.

Përcaktimi më i saktë i datës do të shërbente për të vërtetuar nëse "Meshari" i Gjon Buzukut është i pari libër i shkruar në shqip apo më në fund gjuhësia ka arritur të gjejë dokumente të tjerë që e vërtetojnë këtë gjë. Në foto jepet fleta e një libri fetar, i shkruar në italisht dhe në shqip. "Scala I. Ligierata VI. Si e krijoi 3ot\$ne Adamne et Evene. Të parët tanë print", që kuptohet

"Ligjërta e VI. Si e krijoi Zoti Adamin dhe Evën, prindërit tanë të parë".


Në gjurmët e Joklit Dy profesorët austriakë kanë përdorur materialet dhe dokumentet e themeluesit të shkencës së Al-

gjuhëtarët pranojnë se shqipja duhet të jetë shkruar shumë kohë më parë, dokumenti i parë që e dëshmon këtë është "Formula e pagëzimit", e shkruar nga kryepeshkopi i Durrësit, Pal Ëngjelli, gjatë një vizite në dioqezën e

pari libër në gjuhën shqipe. "Meshari" i përket vitit 1555. Por të gjithë studiuesit janë të një mendimi kur flasin për dokumentet më të hershme.

Këtë e dëshmon dhe Arqipeshkvi francez i Tivarit me

një qarkore latinisht, ku lejon që në kohë lufte fëmijët të pagëzoheshin në shqip. Formula është: «Un të pagëzoni prëmen» Atit e t»birin e t»shpirtit shenjt» shqip. Fjalori i Arnold Fon Harfit (1497) Janë 26 fjalë shqip, 8 shprehje



banologjisë, Norber Jokl. Jokl ka lindur në 25 shkurt 1887 dhe është vranë nga nazistët në maj 1942. Edhe pse me një formim juridik, Jokl iu përkushtua gjuhësisë dhe kryesisht studioi gjuhët indo-evropiane, gjuhët sllave dhe gjuhët romane. Një vëmendje të veçantë i ka kushtuar gjuhës shqipe. Në moshën 30-vjeçare mësoi gjuhën shqipe. Është autor i librave "Studime mbi etimologjinë dhe fjalëformimin e shqipes" dhe "Kërkime gjuhësore - kulturore historike nga fusha e shqipes".

Dokumentet e hershme të shqipes Deri më sot tre cilësohen si dokumentet më të hershme të shqipes. Edhe pse gjithë

Matit në 8 nëntor 1462. Dokumenti i dytë është fjalori i Von Harfit, i vitit 1497.

Dokumentet që përmban një numër fjalësh dhe shprehjesh që i duheshin udhëtarit gjerman gjatë kalimit të tij në Shqipëri në Durrës dhe në Ulqin. Të së njëjtës rëndësi, gjuhëtarët rendisin dhe "Perikopeja e Ungjillit të Pashkës". Një dokument i shkruar në greqisht, që mendohet se i përket shekullit XV ose fillimit të shekullit XVI. Ky dokument përbëhet nga 2 pjesë të vogla Bible në gjuhën shqipe, që u gjetën në një dorëshkrim greqisht të shekullit XIV. Por si dokumenti më i rëndësishëm deri më sot mbahet "Meshari" i Gjon Buzukut, i

emrin Brokard, që ka udhëtuar në Shqipëri. Në një relacion latinisht të vitit 1332, ai shkruan: "Sado që shqiptarët kanë një gjuhë fare të ndryshme nga gjuha latine, prapë ata kanë në përdorim edhe në tërë librat e tyre shkronjën latine". Një gjë mund të thuhet me siguri: Nëse dokumentet shqipe ekzistojnë, zbulimin e tyre mbetet ta presim gjithmonë nga të huajt. Formula e Pagëzimit 1462 Dokumenti i parë i vërtetuar i shqipes i përket datës 8 nëntor 1462.

Është shkruar nga Kryepeshkopi i Durrësit, Pal Ëngjelli, gjatë një vizite në dioqezën e Matit. Duke parë mangësitë në ushtrimin e fesë, Pal Ëngjelli lëshon

dhe numrat nga 1 deri 10 dhe 100 e 1000. Fjalori modest i udhëtarit Arnold Fon Harfit ka një rëndësi të madhe për gjuhën shqipe, duke qenë është i pari dokument i shprehjeve dhe numrave.

Fjalori është zbuluar në vitin 1860, Fon Harvi udhëtoi në Durrës dhe në Ulqin. "Meshari" i Buzukut 1555 Është i pari libër i gjuhës shqipe që është gjendur deri më sot. "Meshari" përbëhet nga 110 fletë ose 220 faqe. Originali i librit që ka arritur të gjendet përbëhet nga 94 fletë. Libri është kishtar dhe është shkruar në gjuhën latine, ka 154 000 fjalë. Është në dialekt verior dhe originali gjendet në Arkivat e Vatikanit.